

SPECIFIKIME TEKNIKE PER AKSESORET E LINJAVE ABC DHE TOKEZIME

AKSESORËT PËR LINJAT TU ME KABLO AJRORE	4
KERKESA TE DETYRUESHME	4
A1. NYJE LIDHESE TE IZOLUARA(KONEKTORE) TE PA DEPERTUESHME NGA UJI(WATERPROOF)	4
1. Nyje lidhese e izoluar per linjen kryesore(bashkuese)	4
a. Nyje lidhese e izoluar per linjen kryesore(bashkuese)	4
b. Nyje lidhese e izoluar per lidhjen e percjellesit te linjes ABC me percjellesa te cveshur	5
2. Nyje lidhese te izoluara(konektore) rakorduese dhe abonenti	6
3. Nyje lidhese te izoluara(konektore) abonenti	7
4. Tubo bashkues te paraizoluar te papershkueshem nga uji(waterproof)	8
A2. TIRANTUESIT	9
TIRANTUES ANKEROR I THJESHTE(TIRANTUES ABONENTI)	9
a. Tipi me krah hark celiku unik	9
b. Lloji me krah hark celiku fleksibel	10
1. Tirantues ankeror(Tirantues linje)	11
a. Tipi ne forme pjastre	11
b. Lloji me krah hark celiku unik	12
c. Lloji me krah hark celiku fleksibel	12
A3. AKSESORET SHTYLLORE DHE FIKSUES	13
1. Aksesori Shtyllor(Qaforet per fiksim)(set)	13
a. Aksesori shtyllor(Qafore) per terheqje ne nje krah	13
b. Aksesori Shtyllor (Qafore) perterheqje ne dy krahe	14
c. Aksesori shtyllor(Qafore) abonenti dhe qafore linje dhe abonenti	15
Tipi 1	15
Tipi 2:	16
2. Bulon me ganxhe	17
3. Fasheta plastike	17
4. Bulon ganxhë forme sy i apur për beton me up metalik	18
5. Shtrengues fundor(Tensionues)	19
Sy-Ganxhe	19
Sy-Sy	19
Ganxhe-Ganxhe	19
6. Tirantues ankeror	20
7. Mbrojteset metalike te kabllit ne shtyllat e betonit	20
a. Mbrojtës kablli në formë të rrumbullakët	20
Tipi 1	20
Tipi 2	21
8. Aksesori per fiksimin e tirantuesit ankeror ne qafore	22

Aksesore per linja ABC dhe tokezime

9. Aksesore per fiksimin e tirantuesit ne mur	23
A4. AKSESORE BASHKUES PER ABC	24
1. Gilza me bulona	24
2. Tub izolues me termotkurjepër gilzat me bulon dhe kablllo	25
3. Koke fundore prej gome	26
4. Gushore e izoluar me termotkurje me katër gishtëza	27
A5. Pajisje për sigurinë, tokëzimin dhe qarku i shkurtër	28
TOKËZIMI	28
a. Përcjellës per tokezim	28
I. Litar celiku	28
II. Shirit celiku	30
III. Zbare bakri fleksibel, te sheshta	31
b. Elektrodat e tokëzimit	32
c. Shkeputes tokezimi per percjellesin e tokezimit	34
I. Morsete universale	34
II. Shkeputes shirit	35
a. Shkeputes shirit - shirit	35
b. Shkeputes litar - shirit	36
III. Morsete tokezimi per bashkim shirit-shirit	36
IV. Fiksues per percjellesin e tokezimit ne faqe te murit ose beton	37
UPA PLASTIK UNIVERSAL ME VIDE ME KOKE ME FILETO METRIKE	37
A6. AKSESORË BASHKUES PËR RRJETIN ME KABELL AJROR	38
a1. Kapikordat Al-Cu per kabllin TU	38
a2.Kapikorda tubolare Alumini me presim	39

Aksesorët për linjat TU me kablllo ajrore

Kerkesa të detyrueshme

Eshtë e detyrueshme që për të gjithë materialet e përkrahura me poshtë furnizuesi në momentin e dorëzimit të mallit të sigurojë:

- Te dhëna teknike siç kerkohen në specifikime teknike
- Te gjithë test raportet e fabrikës si në specifikimet teknike
- Skicat dhe dimensionet
- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te kenë marketim CE

Aksesorët për kabllot ajrorë që duhen siguruar janë përshkruar më poshtë.

Dimensionimi dhe paraqitja ilustruese jepet me poshtë.

Te gjitha materialet duhet të jenë konform standarteve me të fundit SSH, EN, IEC ose ekuivalenteve të tyre (si psh SSH EN IEC 61238, (bashkues mekanik dhe me kompresion për kabllot elektrike të përzier të kabllit ABC), VDE 0211, VDE 0220, NFC 330 20 etje, për nyjet lidhëse; VDE 0211, NF C 33 042, .

Te gjitha materialet Fe duhet të jenë të galvanizuar në të nxehtë ose siç specifikohet konkretisht në materialin me poshtë.

Furnizuesi/Kontraktori/Aplikanti mund të propozojë një gamë dhe një paraqitje të ngjashme e cila duhet të marrë miratimin para dhënies së kontratës.


A1. Nyje lidhëse të izoluar (konektore) të pa depertueshme nga uji (waterproof)

1. Nyje lidhëse të izoluar për linjen kryesore (bashkuese)

a. Nyje lidhëse të izoluar për linjen kryesore (bashkuese)

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet janë orientuese)



Karakteristika

Nyja lidhëse të izoluar për linjen kryesore (bashkuese) është projektuar për të realizuar lidhjen elektrike të magjistratit dhe të degezimeve të linjes me përcjellës alumini me vetëmbajtje me të

njeitin seksion, pa e hequr izolimin e percjellsave. Ne kete menyre nuk lihen ne percjellsat kryesore dhe ata te abonentit, pjese percjellese te zhveshura. Kontaktet e tyre duhet te jene projektuar prej materiali qe te lejoje lidhjen elektrike ne percjellsa prej alumini dhe bakri. Bulloni shtrengues duhet te jete i paisur me kapuc izolues. Gjate shtrengimit te bulonit “dhembet” duhet te levizin drejt percjellsave te izoluar, diametralisht poshte dhe lart, duke u futur fillimisht ne pjesen e izolimit te percjellsave, duke e depertuar ate dhe pastaj ne brendesi te materialit te percjellsave. Rezistenca e kontaktit qe realizohet duhet te jete ne temperaturen 20 oC jo me i madh se 265 mikro Ohm, por jo me e madhe se 0.815 e vleres se rezistences se percjellesit me seksion me te vogel qe mer pjese ne lidhje. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet te zvogeloje qendrueshmerine mekanike te percjellsave. Pjeset plastike izoluese duhet te jene prej polimeresh te perforcuara me fibra xhami dhe rezistente ndaj rezatimit ultraviolet


Parametrat teknike

Seksioni i percjellesit kryesor (min-maks)	Seksioni i degezimit (min-maks)
[mm ²]	[mm ²]
16-95	16-95
25-120	25-120

b. Nyje lidhese e izoluar per lidhjen e percjellesit te linjes ABC me percjellesa te cveshur

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrimi dhe perdorimi

Kjo nyje eshte projektuar per te realizuar lidhjen elektrike te linjes me percjelles alumini me vetembajtje(linja ABC) me percjellesa te cveshur (Al, Cu e tje).

Kjo nyje eshte nje kombinim midis nyjeve te izoluar te zakonshme te linjave ABC dhe morsetave qe perdoren per linjat ajrore me percjellesa te cveshur. Bulloni shtrengues duhet te jete i paisur me kapuc izolues.

Gjate shtrengimit te bulonit “dhembet” qe jane ne pjesen ku futet percjellesi i linjes ABC, duhet te levizin drejt percjellsave te izoluar, diametralisht poshte dhe lart, duke u futur fillimisht ne pjesen e izolimit te percjellsave, duke e depertuar ate dhe pastaj ne brendesi te materialit te percjellsave.

Rezistenca e kontaktit qe realizohet duhet te jete ne temperaturen 20 °C jo me i madh se 265 mikro Ohm, por jo me e madhe se 0.815 e vleres se rezistences se percjellesit. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet te zvogeloje qendrueshmerine mekanike te percjellsave.

Ndersa pjeset paralele ku futet percjellesi i cveshur, gjate shtrengimit te bullonit, levizin edhe ato diametralisht poshte dhe lart njesoj si te morsetat e zakonshme qe perdoren ne percjellesat e cveshur duke realizuar nje rezistence kontakt me vlerat qe u permenden me lart . Ne rastin kur perdoren per percjellesa Al, te dy pjeset e sipermja dhe e poshtme jane te perbera prej aliazhi alumini me qendrushmeri te larte. Ne rastin kur perdoren per percjellesa Cu, ato jane perbere prej bakri te paster elektrolitik .


Te dhena teknike

Seksioni i percjellesit(mm ²)		Buloni	Momenti i shtrengimit(Nm)
Percjellesi i cveshur	Percjellesi i linjes ABC		
16-95	16-95	2xM8	16

2. Nyje lidhese te izoluara(konektore) rakorduese dhe abonenti

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Karakteristikat

Nyja lidhese e izoluar rakorduese eshte projektuar per te realizuar lidhjen elektrike te percjellsave te linjes me percjelles alumini me vetembajtje me degezimet qe nuk kane te njejtin seksion si dhe me kabllin e abonentit, pa e hequr izolimin e percjellsave. Ne kete menyre nuk lihen ne percjellsat kryesore dhe ata te abonentit, pjese percjellese te zhveshura. Kontaktet e tyre duhet te jene projektuar prej materiali qe te lejoje lidhjen elektrike ne percjellsa prej alumini dhe bakri. Bulloni shtrengues duhet te jete i paisur me kapuc izolues. Gjate shtrengimit te bullonit “dhembet” duhet te levizin drejt percjellsave te izoluar, diametralisht poshte dhe lart, duke u futur fillimisht ne pjesen e izolimit te percjellsave, duke e departuar ate dhe pastaj ne brendesi te materialit te percjellsave. Rezistenca e kontaktit qe realizohet duhet te jete ne temperaturen 20 oC jo me i madh se 265 mikro Ohm, por jo me e madhe se 0.815 e vleres se rezistences se percjellesit me seksion me te vogel qe mer pjese ne lidhje. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet te zvogeloje qendrueshmerine mekanike te percjellsave. Pjeset plastike izoluese duhet te jene prej polimeresh te perforcuara me fibra xhami dhe rezistente ndaj rezatimit ultraviolet


Parametra Teknike

Seksioni i percjellesit kryesor (min-maks)	Seksioni i degezimit (min-maks)
[mm ²]	[mm ²]
16-95	4-35(50)

3. Nyje lidhese te izoluar(konektore) abonenti

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Karakteristika

Nyja lidhese e izoluar per abonentin eshte projektuar per te realizuar lidhjen elektrike te percjellsave te linjes me percjelles alumini me vetembajtje me percjellsat e linjes qe furnizojne abonentin, pa e hequr izolimin e percjellsave. Ne kete menyre nuk lihen ne percjellsat kryesore dhe ata te abonentit, pjese percjellese te zhveshura. Kontaktet e tyre duhet te jene projektuar prej materiali qe te lejoje lidhjen elektrike ne percjellsa prej alumini dhe bakri. Bulloni shtrengues duhet te jete i paisur me kapuc izolues. Gjate shtrengimit te bulonit “dhembet” duhet te levizin drejt percjellsave te izoluar, diametralisht poshte dhe lart, duke u futur fillimisht ne pjesen e izolimit te percjellsave, duke e depertuar ate dhe pastaj ne brendesi te materialit te percjellsave. Rezistenca e kontaktit qe realizohet duhet te jete ne temperaturen 20 oC jo me i madh se 265 mikro Ohm, por jo me e madhe se 0.815 e vleres se rezistences se percjellesit me seksion me te vogel qe mer pjese ne lidhje. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet te zvogeloje qendrueshmerine mekanike te percjellsave. Pjeset plastike izoluese duhet te jene prej polimeresh te perforcuara me fibra xhami dhe rezistente ndaj rezatimit ultraviolet
Nyja lidhese izoluese eshte paisur me kapuc te izoluar .

Zbatimi

Nyja lidhese e izoluar abonenti sherben për të realizuar lidhjen elektrike të përcjellësve të linjës me përcjellës alumini me vetembajtje me përcjellësit e linjës të cilat furnizojnë abonentin(pergjithesisht nje fazor).


Parametra Teknike

Seksioni i percjellesit kryesor (min- maks)	Seksioni i degezimit (min- maks)
[mm ²]	[mm ²]
16-95	1.5-10

4. Tubo bashkues te paraizoluar te papershkueshem nga uji(waterproof)

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Karakteristika

Tubot bashkues te paraizoluar te papershkueshem nga uji(waterproof) sherbejne per bashkimin e percjellesave ABC .

Ata jane te perbere prej alumini per percjellesit e fazave dhe aliazh alumini per percjellesin e neutrit. Ne mes tubat kane nje ndalese. Tubi eshte i veshur me nje mbulese izoluese termoplastike. Ne te jane te shenuara edhe vendet e presimit. Nga Brenda tubat jane te luer me graso rrymepercjellese. Ng ate dy anet tubat jane te taposur me unaza elastomerike me nje ngjyre te caktuar per cdo seksion..

Tubat jane prodhuer dhe testuar sipas standarteve perkatese SSH, EN ose IEC ose ekuivalenteve te tyre si psh NFC33021. Ata jane te qendrushem ndaj ujit dhe duhet te kalojne testin prej 6 kv ne uje. Tubat

Aksesore per linja ABC dhe tokezime

bashkues perballojne 50% te ngarkeses ne keputje te percjellesit perkates. Ne rastet kur kablli vetembahet ne neuter ata perballojne 100% te ngarkeses ne keputje te percjellesit te neutrit.

Te dhena teknike per tubat bashkues

Seksioni [mm ²]	Dimensionet			Ngjyra e tapes
	Ø A(mm)	Ø B(mm)	Ø D(mm)	
16	5.5	5.5	20	blu
25	6.5	6.5	20	portokalli
35	8	8	20	e kuqe
50	9	9	20	e verdhe
70	10.5	10.5	20	e bardhe
95	12.2	12.2	20	gri

Percet bashkimit te percjellesave me seksion te njejte, perdoren edhe tubo bashkuese rakorduese me te dhena sipas tabelës se me sipërme ne perputhje me seksionet perkatese qe do te perdoret. Psh per bashkimin e percjellesit 95 mm² me percjelles 50 mm² perdoret tub bashkues

Seksioni [mm ²]	Dimensionet			Ngjyra e tapes
	Ø A(mm)	Ø B(mm)	Ø D(mm)	
95-50	12.2	9	20	gri/e verdhe

A2. Tirantuesit

Tirantues ankeror i thjeshte(Tirantues abonenti)

Karakteristika



Aksesori “**Tirantues ankeror I thjeshte**” për linjat me kablllo alumini me vetembajtje shërben për të fiksuar kabllin e abonentit. Ato janë projektuar për të fiksuar kablllo njëfazor dhe trefazor. Tirantuesi ankeror I thjeshte fikson te gjithë kabllin.

Trupi metalik I tirantuesit ankeror, si ne rastin kur eshte ne forme pjastre ashtu edhe ne forme rethore, realizohet prej celiku te galvanizuar. Fiksimi dhe shtrengimi i percjellsave te linjes realizohet nepermjet nje sistemi paketash polimere te perforcuara me fibra xhami, rezistent ndaj rezatimit ultraviolet, te tipit veteshtrengues ku kablli ze vend(fle) ne folene e vet. Sistemi i pllakave prej polimeresh fiksohet ne trupin metalik te tirantit ankeror me anen e prizhionierave fiksuës. Per te shmangur sforcimet e pa nevojshme, tirantuesit jane me krah te levizshem dhe te rotullueshem ne perputhje me drejtimin e orientimit te vete linjes duke krijuar nje cift rotullues.

a. Tipi me krah hark celiku unik

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)




Parametra Teknike

Diametri i kabllit te ankoruar	Ngarkesa
[mm]	[kN]
Ø3.5-5.5	3
Ø 5.6-7.5	3
Ø9 -17	3
Ø6 -21	3
Ø18-25	3

b. Lloji me krah hark celiku fleksibel

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Parametra Teknike

Diametri i kabllit te ankoruar	Ngarkesa
[mm]	[kN]
Ø3.5-5.5	3
Ø 5.6-7.5	3
Ø9-17	3
Ø6 -21	3
Ø18-25	3

1. Tirantues ankeror(Tirantues linje)

Karakteristika

Aksesori “**Tirantues ankeror**” për linjat me kabllo alumini me vetembajtje shërben për fiksimin, shtrëngimin dhe qendrueshmerine e këtyre linjave. Ato janë projektuar për të realizuar qendrueshmerine e sistemit me katër përcjellës për të gjithë seksionet nga 4x16 mm² deri në 4x95 mm².

Trupi metalik i tirantuesit ankeror përbëhet prej çeliku te galvanizuar.

Fiksimi dhe shtrëngimi i përcjellësve të linjës realizohet përmes një pakete polimeri.

Ato janë perforcuar me fibra qelqi; qe janë rezistente ndaj rrezatimit UV; te tipit vete-shtrenguese ku çdo përcjellës ka nga një vrimë. Sistemi i pllakave prej polimeri i fiksohet trupit metalik të tirantuesit ankeror përmes prixhionerëve fiksues.

Per te shmangur sforcimet e pa nevojshme, tirantuesit ankerore jane me krah te levizshem dhe te rotullueshem ne perputhje me drejtimin e orientimit te vete linjes duke krijuar nje cift rotullues. Qendrueshmeria dhe parametrat teknike te “tirantuesave ankeror“ duhet te jene ne plotesim te kerkesave te standarteve SSH, EN ose IEC ose ekuivalenteve te tyre si psh VDE 0211/ESI 43-14.


Zbatimi

Aksesori “**Tirantues ankeror**” për linjat me kabllo alumini me vetembajtje shërben për fiksimin, shtrëngimin dhe qendrueshmerine e këtyre linjave.

a. Tipi ne forme pjastre

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Parametrat Teknike

Përcjellësi I ankoruar	Ngarkesa
[mm ²]	[kN]
4x16-95	5
4x16-120	5
4x25-4x50	5
4x35-4x95	5

b. Lloji me krah hark celiku unik

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)




Parametrat Teknike

Përcjellësi I ankoruar	Ngarkesa
[mm ²]	[kN]
4x16-95	5
4x16-120	5
4x25-4x50	5
4x35-4x95	5

c. Lloji me krah hark celiku fleksibel

Ilustrimi



Parametrat Teknike

Përcjellësi I ankoruar	Ngarkesa
[mm ²]	[kN]
4x16-95	5
4x16-120	5

Aksesore per linja ABC dhe tokezime

4x25-4x50	`5
4x35-4x95	5

A3. Aksesoret Shtyllore dhe fiksues

Gama propozuar e dimensioneve dhe e skicave ilustruese paraqitet më poshtë.

Furnizuesit/Kontraktori/Aplikanti mund të propozojë një gamë dhe skica të ngjashme të cilat duhet të marrin miratimin para dhënies së kontratës.

Pjese e tyre jane edhe elementet fiksues(bulona, dado, rondele)

1. Aksesori Shtyllor(Qaforet per fiksim)(set)

a. Aksesori shtyllor(Qafore) per terheqje ne nje krah

Keta projektohen per t'u fiksuar ne to "tirantuesit ankerore te linjes" dhe per te trasmetuar ne shtylle sforcimet mekanike te linjes me percjelles alumini me vetembajtje.

Materiali Çelik SSH EN 10025, 50x6 mm I galvanizuar në të nxehtë trashesia e galvanizimit jo me e vogel se 60 µm. Te gjitha buzet do te jene me zmuso(te rumbullakosura).

Qendrueshmeria mekanike e tyre per secilin nga "nyjet" e tij ku fiksohet "tirantuesi ankerues", duhet te jete jo me pak se 45 kN.


Gama propozuar e dimensioneve dhe e skicave ilustruese paraqitet më poshtë.

Furnizuesit/Kontraktori/Aplikanti mund të propozojë një gamë dhe skica të ngjashme të cilat duhet të marrin miratimin para dhënies së kontratës.

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)





ϕD	ϕd	e
[mm]	[mm]	[mm]
61	18	12
77	18	12
120	18	20
130	18	20
140	18	20
160	18	20
180	22	20
190	22	20
220	22	20
240	22	20
260	22	20

b. Aksesori Shtyllor (Qafore) perterheqje ne dy krahe

Keta projektohen per t'u fiksuar ne to "tirantuesit ankerore te linjes" dhe per te trasmetuar ne shtylle sforcimet mekanike te linjes me percjelles alumini me vetembajtje.

Materiali Çelik SSH EN 10025, 50x6 mm I galvanizuar në të nxehtë trashesia e galvanizimit jo me e vogël se 60 μm . Te gjitha buzët do të jenë me zmusë (te rumbullakosura).

Qendrueshmeria mekanike e tyre per secilin nga "nyjet" e tij ku fiksohet "tirantuesi ankerues", duhet te jete jo me pak se 45 kN.


Gama e propozuar e dimensioneve dhe e skicave ilustruese paraqitet më poshtë.

Aksesore per linja ABC dhe tokezime

Furnizuesit/Kontraktori/Aplikanti mund të propozojë një gamë dhe skica të ngjashme të cilat duhet të marrin miratimin para dhënies së kontratës.

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



ϕD	ϕd	e
[mm]	[mm]	[mm]
61	18	12
77	18	12
120	18	20
130	18	20
140	18	20
160	18	20
180	22	20
190	22	20
220	22	20
240	22	20
260	22	20

c. Aksesori shtyllor(Qafore) aboneti dhe qafore linje dhe abonenti

Çelik SSH EN 10025, galvanizim në të nxehtë, $\phi d = 12-14$ mm

Qendrueshmeria mekanike e tyre per secilin nga “nyjet” e tij ku fiksohet “tirantuesi ankerues”, duhet te jete jo me pak se 45 kN.

Gama e propozuar e dimensioneve dhe e skicave ilustruese paraqitet më poshtë.

Furnizuesit/Kontraktori/Aplikanti mund të propozojë një gamë dhe skica të ngjashme të cilat duhet të marrin miratimin para dhënies së kontratës.


Tipi 1

Ilustrimi


(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)

Aksesore per linja ABC dhe tokezime

Qafore abonenti



Qafore linje dhe abonenti



Dmin-Dmaks [mm]
140-170
170-210
200-240
240-280

d=12mm celik I rumbullakte I galvanizuar ne te nxehte

Tipi 2:

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)

**Qafore
abonenti**




**Qafore linje
dhe abonenti**



Dmin-Dmaks mm]
130-150
150-170
170-200
200-250
250-300

2. Bulon me ganxhe

Celik I derdhur I degezuar sipas SSH EN 10083, I galvanizuar në të nxehtë
Sherben per fiksimin e tirantuesit ankeror ne shtyllat e drurit.



L [mm]	M [mm]	Φ [mm]
200	16	16
250	16	16
200	20	20
250	20	20

3. Fasheta plastike

Illustrimi

(Ilustrime dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrimi, kerkesa, te dhena

Ky specifikim mbulon kerkesat per fashetat PVC.

Temperatura e punes: - 40°C deri + 80°C

Rezistenca ndaj zjarit 650 °C

Rezistente ndaj kimikateve, vajrave, lubrifikanteve, yndyrnave, alkolit

Me buze te rumbullakosura per te parandaluar demtimin e percjellesit

Rezistent ndaj razatimit UV

Ngjyra : e zeze, e bardhe, ose sipas kerkeses

Fashetat duhet te jene ne perputhje me SSH EN 62275:2015: Sistemi i menaxhimit të kablllove -
Fasheta për kablllo për instalime elektrike


Te dhena teknike

Aksesore per linja ABC dhe tokezime

Gjeresia (mm)	Gjatesia (mm)	Diametri max qe fikson (mm)	Qendrueshmeria ne terheqje (kG)
2.4	75	1.5 - 18	7.5
2.5	96	1.5 - 23	8.2
2.5	100	1.5 - 25	8.2
2.5	100	5 - 25	8.2
2.5	140	1.5 - 35	8.2
2.5	200	10 - 50	8.2
2.5	203	1.5 - 55	8.2
3.6	150	2.5 - 39	13.6
3.6	203	2.5 - 55	13.6
3.6	292	2.5 - 85	13.6
4.2	205	2.5 - 60	17
4.6	200	10 - 50	20
4.8	190	2.5 - 52	22.7
4.8	280	2.5 - 81	22.7
7.6	100	4 - 35	54.5
7.6	200	4 - 50	54.5
7.6	300	4 - 80	54.5
7.6	380	4 - 110	54.5
8	450	4 - 128	80
8	550	4 - 160	80
9	610	5 - 185	80
9	710	5 - 209	80
9	780	5 - 227	80
9	914	5 - 270	80
9	1220	10 - 372	80
9	1500	10 - 462	80

4. Bulon ganxhë forme sy i apur për beton me up metalik

	L_t	P	ϕ_f [mm]	ϕ_v
M12	75	100	22	12
M16	102	130	29	16




Çelik SSH EN 10025, I galvanizuar në të nxehtë

5. Shtrengues fundor(Tensionues)

Sy-Ganxhe


$L_{max} - L_{min}$	d	b	M
	[mm]		
110	10	8	6
110	11	9	8
125	14	11	10
125	15	14	12
140	18	14	14
170	25	16	16
200	25	18	20



Çelik SSH EN 10025, I galvanizuar në të nxehtë

Sy-Sy


$L_{max} - L_{min}$	b	M
	[mm]	
110	10	6
110	11	8
125	14	10
125	15	12
140	18	14
170	25	16
200	25	20



Çelik SSH EN 10025, I galvanizuar në të nxehtë


Ganxhe-Ganxhe

$L_{max} - L_{min}$	b	M
	[mm]	
110	8	6
110	9	8
125	11	10
125	14	12
140	14	14
170	16	16
200	18	20



Çelik SSH EN 10025, I galvanizuar në të nxehtë

6. Tirantues ankeror



7. Mbrojteset metalike te kabllit ne shtyllat e betonit

Mbrojteset metalike te kablllove ne shtyllat e betonit kane forme “L” ose te rumbullakte dhe prodhohen prej fleteve te celikut me trashesi 3mm dhe te galvanizuara ne te nxehte me nje shtrese zingu me trashesi jo me te vogel se $70\mu\text{m}$ ($500\text{gr}/\text{m}^2$).

Ato perfshijne edhe te gjithe aksesoret per montimin e tyre.

Te dhena teknike

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)




a. Mbrojtës kablli në formë të rrumbullakët

Tipi 1

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Aksesore per linja ABC dhe tokezime

L mm	a mm	b mm	t mm	h mm	R mm
2500	100	88	3	100	50

Mbrojtësja e kabllit në formë të rumbullakët përfshin:

- Mbrojtësen metalike të kabllave prej celiku në formë të rumbullakët me gjatësi 2.5 m dhe trashësi 3mm të galvanizuar në të nxehtë me një shtresë zingu me trashësi jo më të vogël se 70µm (500gr/m²).
- Fashetat vetbllokuese prej celiku 0.25x12x1200mm për fiksimin e mbrojtëses në shtyllë

Numri i mbrojtësive metalike të kabllave në shtyllë do të jetë i njëjtë me numrin e kabllave. Për fiksimin në shtyllë do të përdoren minimum 3(tre) fasheta.

Fashetat vetbllokuese prej celiku për fiksimin e mbrojtëses në shtyllë



Fashetat vetbllokuese prej celiku 0.25x12x1200mm , për fiksimin e mbrojtëses në shtyllë duhet:

Të ketë një mekanizëm vetbllokues që lejon përdorim të lehtë dhe të shpejtë,

Qëndrueshmëri të lartë në tërheqje,

Elasticitet të lartë,

Të jetë zjarrdurues,

Të ketë qëndrueshmëri të lartë ndaj agjentëve atmosferikë, korrozionit si dhe acideve dhe bazave të ndryshme.

Materiali: çelik inoksidues # 316


Fashetat vetbllokuese prej celiku për fiksimin e mbrojtëses në shtyllë duhet të sigurojë mbyllje të sigurtë dhe të qëndrueshme. Ajo përdoret në ambiente të brendshme dhe të jashtme.

Tipi 2

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet janë orientuese)

Aksesore per linja ABC dhe tokezime



L	a	b	t	h	R	D
mm	mm	mm	mm	mm	mm	mm
2500	100	88	3	100	50	220
2500	100	88	3	100	50	230
2500	100	88	3	100	50	240
2500	100	88	3	100	50	250
2500	100	88	3	100	50	260
2500	100	88	3	100	50	270
2500	100	88	3	100	50	285
2500	100	88	3	100	50	295
2500	100	88	3	100	50	310
2500	100	88	3	100	50	325

Mbrojtësja e kabllit në formë te rumbullaket perfshin:

- Mbrojtësen metalike te kabllave prej celiku ne forme te rumbullaket ma gjatesi 2.5 m dhe trashesi 3mm te galvanizuar ne te nxehte me nje shtrese zingu me trashesi jo me te vogel se 70 μ m (500gr/m²).
- Qaforet per fiksime ne shtylle po prej celiku te galvanizuar ne te nxehte me gjeresi 30mm dhe trashesi 3mm si dhe dadot dhe bullonat gjithashtu te galvanizuara

Numri I mbrojtëseve metalike te kabllave ne shtylle do te jete I njejte me numrin e kabllave Per fiksimin ne shtylle do te perdoren minimum 3(tre) fasheta. Ato saldoohen pas mbrojtëses. Diametri D varet nga lloji I shtylles ku do perdoret.

Ne cdo rast furnizuesi duhet te kontaktoje blerësin per percaktimin e D.

Aplikimi

Mbrojtësja metalike perdoret për të mbrojtur kabllot dhe përcjellësit nga dëmtimet përgjatë shtyllave si:

- Përcjellës tokëzimi
- Kabllo shërbimi dhe kryesorë të TU
- Kabllo kryesorë të TU-TM
- Kabllot kryesorë të TM

8. Aksesore per fiksimin e tirantuesit ankeror ne qafore



Karakteristikat:

Aksesori per fiksimin e tirantues ankeror sherben per fiksimin e tirantuesit ankeror ne qaforen e kombinuar linje dhe abonenti dhe percjell ngarkesen e linjes ne aksesoren shtyllor e nepermjet tij ne shtylle. Ata projektohen qe te realizojne qendrueshmerine e sistemit me 4 percjellsa per te gjitha seksionet nga 4x16 mm² deri ne 4x95 mm².

Zbatim:

Aksesori per fiksimin e tirantues ankeror sherben per fiksimin e tirantuesit ankeror ne shtyllat e drurit ose te betonit. Ne keto te fundit ai perdoret i kombinuar me aksesoren shtyllor(qaforen) e linjes dhe abonentit.


Parametrat teknike:

Tipi	Dimesionet (mm)			Ngarkesa	Pesha
	a	b	h	[kN]	[kg]
	85	140	170	15	0.25

Vrima per fiksim eshte me diameter 18 mm ose 22

mm sipas kerkeses.

9. Aksesori per fiksimin e tirantuesit ne mur



Karakteristikat dhe perdorimi:

Ky aksesori shërben për fiksimin e tirantuesit ankeror në faqe të murit dhe përcjell ngarkesën e linjes në të. Ata projektohen që të realizojnë qendrueshmërinë e sistemit me 4 përcjellsa për të gjitha seksionet nga 4x16 mm² deri në 4x95 mm².

Fiksimi I tij në mur bëhet dy me upa metalik M12 dhe bulon përkatës për kata upa M12 me koke gjashtëkëndore.

Elementi mbajtes është në formë gjysem rethi me diametër 16mm. Ngarkesa e shkaterimit është 19.5 kN dhe ngarkesa e rekomanduar për shfrytëzim është 7kN

Të gjitha pjesët perberese janë çelik I galvanizuar në të nxehtë.

A4. Aksesore bashkues për ABC



Gama e propozuar e dimensioneve dhe e skicave ilustruese paraqitet më poshtë.

Furnizuesit/Kontraktori/Aplikanti mund të propozojë një gamë dhe skica të ngjashme të cilat duhet të marrin miratimin para dhënies së kontratës.

1. Gilza me bulona

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet janë orientuese)



Karakteristika

Gilzat me bulona janë projektuar për të realizuar lidhjen elektrike të përcjellsve prej alumini dhe të atyre prej bakri. Këto gilza janë të përshtatshme për të gjithë format e përcjellsve: rrethorë, sektorialë, i ngurtë ose elastik. Koka e bulonit shtrëngues parashikohet të pritët kur arrihet “shtrëngueshmëria” e duhur, duke realizuar kështu kontaktin e duhur elektrik, si edhe qëndrueshmërinë e duhur mekanike.

Keto gilza duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve SSH, EN ose IEC ose ekuivalenteve të tyre si p.sh VDE 0220.

Zbatimi

Gilzat me bulon janë projektuar të lidhin përcjellsit prej alumini me ato prej bakri.


Parametrat teknike:

Seksioni I përcjellsit	D	L
[mm ²]	[mm]	[mm]
16-70	25	55
25-150	28	75

2. Tub izolues me termotkurjepër gilzat me bulon dhe kablo

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet janë orientuese)



Karakteristika

Tubat bashkues për gilzat janë projektuar për të realizuar izolimin elektrik të përcjellësve. Është aksesor termo-tkurrës dhe ngjitës duke realizuar kështu hermetizimin e përcjellësit. Furnizimi i tyre bëhet tub i paprerë me gjatësi 1 m. Gjatësia e tubit për çdo përcjellës pritët në varësi të gjatësisë së gilzes.

Ata realizojnë:


- Izolimin elektrik
- Qendrueshmeri të lartë mekanike ndaj mjedisit të jashtëm
- Qendrueshmeri të lartë në mjedise acide dhe alkaline
- Rezistencë të lartë ndaj rrezatimit ultraviolett.
- Duhet të jetë i veshur nga brenda me lëndë ngjitëse termo-tkurrëse, e cila, duke u shkrirë gjatë nxehtësisë, duhet të realizojë ngjitjen e veshjes izoluese me dejet e kablilit.

Tubat me termotkurje duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve SSH, EN, IEC ose ekuivalenteve të tyre si SSH EN 62631-3-1:2016, SSH EN 62631-3-2:2016, SSH EN 60216 SSH EN 60243

Zbatimi

Tubat bashkues për gilzat janë projektuar për të realizuar izolimin elektrik të gilzave.

Parametrat Teknike



Dmin (mm)	dmax (mm)	T±10% (mm)	Dmin (mm)	dmax (mm)	T±10% (mm)
10	3	1.5	70	22	2.7
12	4	1.8	90	28	3.0
19	6	2.0	105	30	3.0
22	6	2.0	115	34	3.2
27	8	2.5	130	36	3.2
30	8	2.6	140	42	3.2
33	10	2.6	160	50	3.3
40	12	2.7	180	60	3.3
50	16	2.7	200	70	3.3

3. Koke fundore prej gome

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrimi, Kerkesa, Te dhena

Kokat fundore prej gome sherbejne per te izoluar skajet e percjellesave te izoluar, me qellim qe te mos lejojne futjen e lageshtires brenda tij. Forma e tyre eshte konike . Vendosen ne fund te percjellesit me perdredhje duke e izoluar plotesisht skajin e tij nga ambient i jashtem.

Ato perbehen prej materiali termoplastik dhe jane rezistente ndaj rezatimit Ultra Violet.

Testohen plotesisht ne tension 6kV dhe nen kushtet e ujit.

Duhet te jene ne perputhje me standartet SSH, EN ,

IEC ose ekuivalenteve te tyre si psh NFC 33 020

Te dhena teknike

Seksioni terthor I dellit (mm ²)
6-35
16-150


Paketimi

Paketohe ne kuti kartoni

4. Gushore e izoluar me termotkurje me katër gishtëza

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Karakteristika

Gushorja e izoluar me katër gishtëza shërben për të bllokuar depertimin e lageshtires ne brendesi të kabllove nëntokësorë ne piken e bashkimit me kabllot me përcjellës alumini te izoluar me vetembajtje(ABC).

Gushoret e izoluar me katër gishtëza jane te llojit me termo-tkurje dhe ngjitje, duke realizuar hermetizimin e dejeve te kabllit nentokesor.

Ata realizojnë:

- Izolimin elektrik të dejeve të kabllit me një tension izolimi i cili vlerësohet në raport me trashësinë jo më pak se 14 kV/mm.
- Qendrueshmeri te larte në mjedise acide dhe alkaline
- Rezistencë të lartë ndaj rrezatimit ultraviolet.
- Duhet të jete I veshur nga brenda me lende termo-tkurrese dhe ngjitëse, i cili duke u shkrirë gjatë nxehtësisë, duhet të realizojë ngjitjen e veshjes izoluese me dejet e kabllit.

Gushoret duhet te plotesojne kerkesat e standarteve SSH, EN ,IEC ose ekuivalenteve te tyre si SSH EN 62631-3-1:2016 , SSH EN 62631-3-2:2016,SSH EN 60216 SSH EN 60243

Zbatimi

Gushorja e izoluar me katër gishtëza shërben për të bllokuar depertimin e lageshtires ne brendesi të kabllove nëntokësorë ne piken e bashkimit me kabllot me përcjellës alumini te izoluar me vetembajtje(ABC).

Materialet janë të përshtatshme për përdorim në të gjitha rajonet.

Parametrat Teknike:

Seksioni i kabllit	H		J		P	R	S	HW	JW
	Para tkurjes min.	Pas tkurjes max.	Para tkurjes min.	Pas tkurjes max.	Pas tkurjes $\pm 10\%$	Pas tkurjes $\pm 10\%$	Pas tkurjes $\pm 10\%$	Pas tkurjes $\pm 20\%$	Pas tkurjes $\pm 20\%$
[mm ²]	[mm]	[mm]	[mm]	[mm]	[mm]	[mm]	[mm]	[mm]	[mm]
4x4-4x35	36	16.5	14	3.4	96	71	25	2.5	1.9
4x25-4x95	45	19	20	7	165	75	40	3.5	2
4x50-4x150	60	25	25	9	217	100	44	3.5	2
4x50-4x150	100	31	40	13.5	223	103	51	3.5	2.5

A5. Pajisje për sigurinë, tokëzimin dhe qarku i shkurtër

Gama e propozuar e dimensioneve dhe e skicave ilustruese paraqitet më poshtë. Furnizuesit/Kontraktori/Aplikanti mund të propozojë një gamë dhe skica të ngjashme të cilat duhet të marrin miratimin para dhënies së kontratës.

TOKËZIMI

a. Përcjellës per tokezim

I. Litar celiku

Pershkrim teknik

Litar celiku I galvanizuar perbehet nga percjellsa celiku te galvanizuar. Litari perbehet nga nje percjelles i vendosur ne vije te drejte ne qender dhe nga nje shtrese percjellesash te tjere te vendosur ne menyre spirale reth tij, sipas akrepave te ores.


Tedhena teknike

Tipi Litar celiku 95 - 400

Ilustrim:

(Ilustrimi dhe dimensionet janë orientuese)

Aksesore per linja ABC dhe tokezime




Parametra teknike

Destinacioni	Njesia	Vlera
Diametri I litarit	mm	12.5 ± 0,1
Seksioni terthor I litarit	mm ²	95
Seksioni I llogaritur	mm ²	93.27
Pesha nominale	kg/km	725.64 ± 2%
Diametri I percjellesit	mm	2,5 ± 0,03
Seksioni I percjellesit	mm ²	4.906
Numri I percjellesave	piece	19
Ndertimi	-	1 + 6 + 12
Qendrushmeria ne terheqje	MPa	400
Forca e garantuar	kN	38
Moduli I elasticitetit	GPa	175
Koeficienti i zgjatimit linear nga temperatura	1/°C	11*10 ⁻⁶

Tipi Litar celiku 150 - 400

Ilustrim:

(Ilustrimi dhe dimensionet janë orientuese)



Parametra teknike

Destinacioni	njesia	Vlera
Diametri I litarit	mm	15.8 ± 0,1
Seksioni terthor I litarit	mm ²	150
Seksioni I llogaritur	mm ²	147.1
Pesha nominale	kg/km	1150.38± 2%

Aksesore per linja ABC dhe tokezime

Diametri I percjellesit	mm	2.25 ± 0,03
Seksioni I percjellesit	mm ²	3.974
Numri I percjellesave	piece	37
Ndertimi	-	1 + 6 + 12 + 18
Qendrushermeria ne terheqje	MPa	400
Forca e garantuar	kN	60
Moduli I elasticitetit	GPa	175
Koeficienti i zgjatimit linear nga temperatura	1/°C	11*10 ⁻⁶

II. Shirit celiku

Përshkrimi Teknik

Shiriti prej çeliku të zinkuar përbëhet nga një shirit çeliku i zhveshur mbuluar me një shtresë zinku me trashësi jo më pak se 70µm (500gr/m²)

Zbatimi

Përcjellësit shirit prej çeliku të galvanizuar shërbejnë për tokëzimin e pajisjeve si përcjellës tokëzimi.

Kërkesat e instalimit

Temperatura minimale e lejuar e mjedisit duhet të jetë -20 ° C.

Gjatë transportit dhe montimit, rrota me shirit çeliku të zhveshur duhet të vendoset me kujdes në mënyrë që shtresa e zinkut të mos dëmtohet.

Gjatë përdorimit të tij për tokëzimin e pajisjeve, shiriti i çelikut i zhveshur çmbështillet me kujdes.

Bashkimi me elementët e tjerë të tokëzimit realizohet përmes morsetave përkatëse.

Mjedisi: ambjente të jashtme dhe nëntokë

Ruajtja, trajtimi dhe transporti

Paketimi i shiritit të çelikut të zinkuar bëhet në rrota, duke fiksuar spiralet me shirita izoluese, në mënyrë që ato të mos çmbështillen dhe të mos dëmtohet shtresa e zinkut. Gjatë transportit, këto rrota me shirit çeliku të zinkuar duhet të sigurohen ndaj lëvizjeve të padëshiruara.

Temperatura e rekomanduar e ruajtjes varion nga -25 °C deri në + 70 °C.

Gjatë ruajtjes për një kohë të gjatë, rekomandohet që rrotat të mbrohen nga faktorët e jashtëm, duke i vendosur nën një tendë ose duke mbështjelle me mushama për t'i mbrojtur nga uji.

Të dhëna teknike

Ilustrim:

(Ilustrimi dhe dimensionet janë orientuese)





Parametra Teknike

Përmasat	Sipërfaqja	Materiali	Pesha
mm	mm ²		kg/km
20x2.5	50	Çel/Zn	400
25x4	100	Çel/Zn	800
30x3.5	105	Çel /Zn	840
30x4	120	Çel /Zn	960
40x4	160	Çel /Zn	1250
40x5	200	Çel /Zn	1670

III. Zbare bakri fleksibel, te sheshta

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrimi

Aksesore per linja ABC dhe tokezime

Zbarat jane shirita bakri qe perdoren ne rrjetat elektrike kryesisht ne N/Stacione, panele, tokezime, etje. Ato kane nje gjatesi, gjeresi dhe trashesi te caktuar.

Ato perbehen nga fije(tela) bakri te kallaisura me diameter 0.10 mm ose 0.30 mm, te thurura ne forme kordonit. Me pas kordonet thuren duke formuar zbaren e sheshte, me nje seksion te caktuar.

Ne dy skajet e zbares vendosen kapikorda te sheshta. Ato jane te galvanizuara dhe te pershtateshme per te percjelle rrymen per te cilen eshte projektuar zbara.

Gjatesia e zbares percaktohet ne kerkesa.

Bakri ka karakteristika te shkelqyera elektrike dhe mekanike. Perdoret baker elektrolitik me pasterti 99.9% Zbarat duhet te kene te kene marketimin CE.

Zbarat duhet te jene ne perputhje me SSH, EN IEC si CENELEC HD21, VDE 0207/86, BS6746/79, DIN 46444, DIN 72333, e tje. ose standarte te tjera ekuivalente.

Te dhena Teknike

Seksioni (mm ²)	Rryma e lejuar (A)	A (mm)	B (mm)	Diametri i birave te kapikordave D (mm)	Rezistenca specifike ne 20 °C (Ω mm ² /m)	Rezistenca mekanike ne terheqje (N/mm ²)
6	55	12	12	6.5	1.7241	Min. 200
10	85	17	22	8.5		
16	120	17	22	8.5		
25	150	21	23	10.5		
35	195	21	23	10.5		
50	250	25	25	10.5		
70	330	30	30	10.5		

Rryma i referohet temperatures se ambientit 35 °C.


Gjatesia L percaktohet ne kerkese. Ne rast se nuk eshte percaktuar, gjatesia L midis akseve te dy brimave te kapikordave do te jete 250 mm.

Sipas kerkeses, mund te perdoren edhe zbara fleksible te rumbullakta, por gjithmone duke respektuar kerkesat teknike te tabelës se me sipërme.

Zbara furnizohet e gateshme per montim.

b. Elektrodat e tokëzimit

Ilustrimi



Përshkrimi, Kërkesat dhe Të Dhënat

Ky specifikim mbulon kërkesat për elektodat e sistemit të tokëzimit. Pjese perberese e electrodes eshte edhe morseta sipas detajit “A”

TË DHËNA TEKNIKE

Formë kryqi “+” jo më pak se 50x5mm, H=1.5 ose 2.0m, që nuk shtrihet/zgjatet
Cilësia e çelikut SSH EN 10025, DIN 17 100 ose ekuivalent me to.
Pajisur me pllakë bashkuese
Paisur me morseten për bashkimin me percjellesin me diameter deri 13mm
I përputhshëm me DIN 48 – 452 ose ekuivalent me te.
Shtresë zinku – minimumi 70 mikron.

Identifikimi dhe Paketimi

Elektrodat do të pakëtohen në kuti kartoni (10 copë).

Çdo kuti do të përmbajë informacion për:

- llojin e elektrodës
- përmasat e elektrodës


- prodhuesin
- vitin e prodhimit
- pesha bruto
- numrin e kutisë

c. Shkeputes tokezimi per percjellesin e tokezimit

I. Morsete universale

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Morseta eshte e perbere prej materiali me nje qendrushmeri shume te larte i cili eshte veshur me nje shtrese anti korrozive zinku me nje trashesi 60 mikron.
Morseta shtrengohet fort me bulona te cilet kane nje shtrese anti korrozive.
Morsetat, bulonat dhe rondelet jane prej celiku te galvanizuar ne te nxehte


Te dhena teknike

Dimensionet [mm]			diam. percjellesit [mm]	Forca e lidhjes(qendrushmerise) [kN]
a	b	M		
50	40	10	2.7-9.4	4.6

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)

Aksesore per linja ABC dhe tokezime



Dimensionet mm			diam. percjellesit	Momenti perdredhjes Nm	F. e lidhjes(qendru shmerise) kN
a	b	c			
52	61	56.4	9-16	45	13.26

Morseta eshte e perbere prej materiali me nje qendrueshmeri shume te larte i cili eshte veshur me nje shtrese anti korrozive zinku me nje trashesi 60 mikron.

Morseta shtrengohet fort me bulona te cilet kane nje shtrese anti korrozive.


Bulonat dhe rondelet jane prej celiku te galvanizuar ne te nxehte

II. Shkeputes shirit

a. Shkeputes shirit - shirit

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Te dhena teknike

Shirit (mm)	L (mm)	L1 (mm)	C (mm)	M1	M	Pesha (kg)
25x4	80	66	50	M10x30	M12x30	0.33

Materiali i shkeputesit, bulonat,dadot, rondelet jane prej celiku te galvanizuar ne te nxehte sipas SSH EN 10025,DIN 17100,ose ekuivalent me to.


Aksesore per linja ABC dhe tokezime

Shkeputesi do te lidhe shiritin e galvanizuar ne te nxehte 25x4 mm me shiritin 25x4 mm.

b. Shkeputes litar - shirit

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Te dhena teknike

Shirit & Litar (mm)	L (mm)	L1 (mm)	C (mm)	S (mm)	M	Pesha (kg)
40x4 - Max. $\varnothing_D=12$	60	60	40	4	M6x30	0.25


Materiali i shkeputesit, bulonat, dadot, rondelet jane prej celiku te galvanizuar ne te nxehte sipas SSH EN 10025, DIN 17100, ose ekuivalent me to. Shkeputesi do te lidhe litarin e galvanizuar ne te nxehte me diameter D me shiritin 40 x4 mm.

III. Morsete tokezimi per bashkim shirit-shirit

Te dhena teknike

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Aksesore per linja ABC dhe tokezime

Shirit (mm)	L (mm)	L1 (mm)	C (mm)	S1 (mm)	S2 (mm)	M
25x4	60	60	40	4	4	8
25x4	60	60	40	4	4	10
40x4	80	80	60	4	4	8
40x4	80	80	60	4	4	10

Te gjitha pjeset perberese jane prej celiku te galvanizuar ne te nxehte

IV. Fiksues per percjellesin e tokezimit ne faqe te murit ose beton

Tipi per fiksimin e percjellesit shirit

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Sherben per fiksimin e percjellesit te tokezimit forme shiriti ne faqe te murit ose betone. Madhesia maksimale e shiritit qe fiksohet eshte 40x4mm. Bullonat shtrengues jane M6x16mm. Ne pjesen e fiksimit, fiksuesi ka dado me fileto M8mm , e pershtatsheme per montim ne up plastik universal me vide me koke me fileto metrike. Dy pjastrat fiksuse kane spesor 3 mm secila.

Te gjitha materialet jane celik te galvanizuar ne te nxehte.

Tipi per fiksimin e percjellesit te rumbullakte

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Sherben per fiksimin e percjellesit te tokezimit te rumbullaket ne faqe te murit ose betone. Diametri maksimal i percjellesit qe fiksohet eshte Φ 8-12mm. Bullonat shtrengues jane M6x16mm. Ne pjesen e fiksimit, fiksuesi ka dado me fileto M8mm , e pershtatsheme per montim ne up plastik universal me vide me koke me fileto metrike. Pjastrat fiksuse kane spesor 3 mm.


Te gjitha materialet jane celik te galvanizuar ne te nxehte.

Upa plastik universal me vide me koke me fileto metrike

Ilustrim

(Ilustrimi eshte orientues)

Aksessore per linja ABC dhe tokezime



Pershkrim

Upi plastik është bërë nga material polyamid 6, dhe buloni është bërë nga çelik i galvanizuar (zingu i bardhë). Në raste të veçanta buloni mund të bëhen prej bronzi. Koka e bulonit është me fileto metrike.

Applikimi

Përdoret për fiksimin e elementeve të ndryshme në sipërfaqet e mureve, në dysheme, tavan e tje.

Te dhena Teknike

Tipi (mm)	Punto Ø (mm)	Gjatesia e ankorimit	Thellessia minimale e cpimit (mm)	Filetua e kokës bulonit x gjatesia pjeses filetuar (mm)
	d_0	l	h_0	
6x35	6	35	45	M6x12
8x35	8	35	45	M8x15


A6. Aksesore bashkues për rrjetin me kabell ajror

Gama e propozuar e dimensioneve dhe e skicave ilustruese paraqitet më poshtë.

Furnizuesit/Kontraktori/Aplikanti mund të propozojë një gamë dhe skica të ngjashme të cilat duhet të marrin miratimin para dhënies së kontratës.

a1. Kapikordat Al-Cu për kabllin TU

Ilustrim



Përshkrimi, Kërkesat, Të Dhënat.

Ky specifikim mbulon kërkesat për kapikorda për:

- Litar alumini, me sipërfaqe të prerjes tërthore 95 mm².

Kapikordat do të prodhohen sipas Standardeve SSH EN IEC ose standardeve të tjera ekuivalente.

Ndertimi dhe Materiali.

Kapikordat duhet të jenë të përshtatshme për përdorim në perçjellesat litar.

Kapikordat do të përdoren për lidhjen e perçjellesave litar me paisjet.

Kapikordat, në pjesën ku futet perçjellesi do të jetë alumin. Fiksimi i perçjellesit bëhet me presim.

Të dhëna teknike

Seksioni I perçjellesit (mm ²)	Dimensionet (mm)			
	D	D1	D2	L
95	22	13.5	13	90.5


a2.Kapikorda tubolare Alumini me presim

Kapikordat tubolare prej aluminiprodhohen nga tubot e aluminit në përputhje me standartin SSH EN 50182

Ato duhet të jenë rezistente ndaj korrozionit, rezatimit UV. Në to duhet të shenohet vendet e presimit

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet janë orientuese)



Te dhena teknike

Seksioni I perçjellesit (mm ²)	Dimensionet (mm)					Numri I presimeve cop		Pesha per 100 cop (kg)
	a	L	D	D1	D2	mekanik	hidraulik	
95	56	90	22	13	13	6	3	6.35
120	58	91	22.5	15	13	6	3	6.70
150	60	103	25	16.5	17	6	3	9.00

Kapikordat prodhohen në përputhje me standartet SSH EN IEC ose ekuivalentet e tyre.



SPECIFIKIME TEKNIKE IZOLATORE LINJE 10KV, 12KN

1. Te pergjitheshme

Materialet e furnizuara duhet te jene te prodhimit standart ne perputhje me specifikimet e me poshtme. Te gjitha materialet do te jene te projektuara per te siguruar funksionim te kenaqshem sipas kushteve klimatike qe mizoterojne ne vend, pa ndryshuar, perkeqesuar apo ritur tensionin e panevojshem ne cdo pjese.

Materialet do te punojne ne menyre te kenaqeshme per variacione te ngarkeses dhe tensionit, lidhjeve te shkurteraapo kushteve te tjera te sistemit, me kusht qe ato te mbeten brenda vlerave te lejuara te paisjeve. Te gjitha materialet e perdorura ne prodhimin e produkteve duhet te jene te cilesise me te mire dhe ten je lloi te pershtatshem per punen dhe kushtet e specifikuara

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



2. Kërkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi ne momentin e dorezimit te mallit te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhenat teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat me dimensione
- Manual perdorimi
- Te kene marketim CE

3. Kushtet e Sistemit

a	Specifikime	Njesia	Vlera
1	Tensioni nominal ne sistem	kV	10
2	Tensioni me I larte ne sistem	kV	12
3	Frekuenca e sistemit	Hz	50
4	Numri I fazeve	Nr	3 faze
5	Sistemi I tokezimit		I izoluar
b	Kushtet atmosferike		
1	Temperatura maks. e ambientit		50°C
2	Temperatura max. mesatare ditore		30°C
3	Temperatura minimale e ambientit		-10 °C
4	Lageshtia relative maks		90%
5	Lartesia maksimale mbi nivelin e detit		1500m
6	Shpejtesia maksimale e eres		126 km/h
7	Ndotja		mesatare

4. Pershkrim, kërkesa dhe te dhena

Materiali i izolatoreve duhet të jetë porcelan C 110.

Izolatorët duhet të garantojnë një qendrueshmëri mekanike në perkulje në qafen e tyre 12kN.

Izolatorët në pjesën e brendshme duhet të përforcohen me sulfurgrafit si dhe të mbrohen me një shtresë të holle paste siliconi për mos depertimin e lageshtisë.

Ngjyra e izolatoreve duhet të jetë kafe e lustruar.

Në pjesën e jashtme të izolatoreve duhet të stampohet tipi I izolatorit, emri i prodhuesit, tensioni nominal, qendrueshmëria në perkulje në kN, viti i prodhimit.

Kunji i izolatorit duhet të bëhet me çelik të galvanizuar në të nxehtë, M20

Kunji me dado dhe rrodetë është pjesë e përbërësve të izolatorit të furnizuar.

Izolatori transportohet i ndarë nga kunji, dadoja dhe rrodetja.

Të gjitha pjesët e përbërësve për montimin e izolatorit duhet të prodhohen me të njëjtin standart si dhe trupi i izolatorit.

Të gjitha pjesët metalike duhet të mbrohen nga korozyoni me galvanizim në të nxehtë.

Testet e izolatoreve duhet të kryhen në përputhje me standartet SSH EN 60168

Te dhena Teknike

Pershkrimi	Sasia	Vlera
Distanca e izolimit	mm	320
Pesha totale	Kg	2.5
Lartësia totale	mm	166
Lartësia deri në qendër të qafës	mm	128
Diametri i qafës	mm	80
Diametri i kokës	mm	100
Sforcimi i lejuar në qafë	kN	12
Numri i unazave	cop	2
Tipi i materialit (porcelanit)	-	C 110
Tensioni nominal	kV	10
Qendrueshmëria ndaj tensionit të shkarkimeve 1,2 / 50 µsec	kV	70
Qendrueshmëria ndaj tensionit me frekuencë 50Hz	kV	28
Prova me tension AC në kushte të thata	kV	35
Prova me tension AC në kushte me lageshtirë	kV	28
Prova me tension AC në të thatë (për valën +)	kV	78
Prova me tension AC në të thatë (për valën -)	kV	110
Prova me U_{max} , në të thatë	kV	50
Prova me U_{max} , në lageshtirë	kV	36

5. Standartet referuese

Izolatorët e TM duhet të jenë në përputhje me Standartin SSH EN IEC 60383-1, IEC 60273 ose ekuivalente të tyre.

6. Aplikimi

Izolatorët duhet të plotësojnë dy kushte kryesore:

- Mbeshtetja mekanike e përcjellesave të zhveshura në strukturën mbështetëse (traverse).
- Izolimi elektrik i përcjellesave të zhveshura të linjës.

Këta izolatore përdoren për vendosjen e përcjellesave të zhveshura të linjave ajrore me tension 10kV, si për shtyllat ndërmjetëse ashtu edhe për shtyllat këndore dhe ankerore **brenda qendrueshmërisë së lejuar** të tyre.

Për më tepër këta izolatore përdoren për mbajtjen e përcjellesave të zhveshura në tipe të ndryshme të konstruksioneve mekanike mbajtëse (traverse) si dhe të tipeve të ndryshme të shtyllave apo bazamenteve mbajtës metalik.

Duhet te projektohen per te punuar jo ne sforcim.

7. Jetegjatesia

Minimumi 30 vjet

8. Montimi

Izolatoret duhet te montohen ne gjendje te paster, jo me yndyre si dhe ndotje te tjera te siperfaqes se tyre. Keta izolatore shtrengohen ne konstruksioni mbajtes metalik (traverse) me bulon dhe rondere M20. Gjatesia e bulonit te izolatorit varet nga tipi I konstruksionit mbajtes metalik te tyre. Izolatoret duhet te perdoren ne perputhje me stampen e treguar nga prodhuesi.

9. Kontrolli i cilesise

Izolatoret duhet te jene sipas ISO 9001

10. Kerkesa shtese

Ne pjesen e jashtme te izolatorit duhet te stamposen:

- Emir I prodhuesit
- Tipi
- Tensioni nominal
- Qendrushmeria ne perkulje ne kN
- Viti I prodhimit
- Markimi CE

Keto mbishkrime duhet te jene te lexueshme dhe te qendrueshme ndaj kushteve atmosferike dhe rezeve UV

11. Amballazhimi

Izolatoret duhet te vendosen ne kuti metalike me pengesa qe te mos rrotullohen, te ndare midis tyre me karton, ose mund te vendosen ne arka druri.

Kur eshte i nevojshem manipulimi i tyre duhet te tregohet kujdes per te eliminuar goditjet ne trupin e tyre ose goditjet me trupa te tjere te forte, per te mos i demtuar ata.

Ne cdo kuti duhet te shenohet informacioni i me poshtem:

- Emri i prodhuesit/Identifikimi
- Vend ii origjines.
- Emri i materialit & Nr. katalogut
- Sasia
- Pesha bruto

12. Informacioni qe duhet te sigurohet me oferten

Informacioni I meposhtem duhet te sigurohet me oferten:

- Versionin anglisht te katalogut qe pershkruan artikullin dhe tregon tipin ,nr.modelin etj.
- Standarti me te cilin izolatoret e jane prodhuar.
- Karakteristikat ndertimore, materiali I perdorur dhe te tjera te dhena teknike.
- Certifikatat testuese si me poshte:
 - Verifikimi I dimensioneve.
 - Prova me shkarkim tensioni ne te thate
 - Prova me shkarkim tensioni ne lageshti
 - Prova e tensionit qe duron ne te thate
 - Prova e tensionit qe duron ne lageshti
 - Prova me shkarkim tension impulsiv
 - Prova me tension impulsive qe duron
 - Prova perfundimtare e fortesise mekanike.
 - Porosity test.
 - Testi termik

- Certifikimi per cilesine sipas ISO 9001.
- Skemat me dimensione te artikujve

Certifikatat e testeve duhet te tregojne identifikimin e artikullit nr. e references dhe parametrat baze. Certifikatat e testeve duhet te jene nga nje autoritet I pavarur testues I pranueshem per bleresin. Deshtime per paisjen me te dhenat e mesiperme mund te coje ne refuzimin e ofertes.

13. Mostrat e verifikimit

Tre izolatore kampion duhet te jene se bashku me oferten per te lehtesuar analizen dhe vleresimin.

14. Kontrolli dhe testimi

Ofertuesi I zgjedhur duhet te beje marrveshjet e nevojshme per kontrollin nga nje inxhinier caktuar nga bleresi dhe te kryeje ne prezencen e tij provat e pranimi per materialet e ofruara.

15. Marrja e kampioneve

Pese izolatore do te perzgjidhen nga nje grup prej 1000 per te kryer testin e pranimi.

Nese ndonje nga izolatore deshton ne proven sipas kerkesave te specifikuara nje tjeter grup prej 5 izolatoresh do te perzgjidhet nga I njeiti grumbull dhe testimi do te perseritet.

Nese perseri nuk plotesohen kerkesat sipas specifikimeve e gjithje sasia 1000 cope do te kthehet.

16. Pranimi/testimet

The Pranimet e meposhtme /testet do te jene:

- Verifikimi I dimensioneve
- Prova me shkarkim tensioni ne frekuencen e fuqise ne kushte lageshtie
- Testi mekanik I ngarkeses
- Testi I porozitetit

17. Literature teknike, Vizatimet dhe tes raportet rutine

Literatura teknike me te skicat e kompletuara me dimensioned per izolatore mbeshtetes dhe raportet e testeve rutine (Testet elektrike dhe testet mekanike, dhe ekzaminimet vizuale dhe testet si me poshte ne kohen e prodhimit. Duhet te jene me oferten.

18. Testet rutine

Kontrrolli vizual

Ngjyra e izolatorit duhet te jete sic pershkruhet ne te dhenat me siper. Siperfaqja e ekspozuar duhet te mbulohet me nje luster te bute pa plasaritje dhe defekte.

19. Testi Porozitetit

Fragmente nga izolatori duhet te testohen ne perputhje me standartet e peraferta.

Nuk duhet te kete plasaritje te bojes etj

Technical Data Sheet			
MV Insulators			
No.	Tipi (Type)	Njesia(Unit)	Data
1	Te dhena te pergjitheshme (GENERAL DATA)		
	Prodhesi (Manufacturer)		
	Vendi prodhimit dhe testit (Place of manufacture and test)		
	Referenca (Type reference)		

Specifikime Teknike – Izolatore Linje 10kV, 12kN

	Material		
2	Detaje (DETAILS)		
	Standarti aplikuar (Applied standard)		
	Frekuenca (Rated frequency)	Hz	
	Tensioni max. i sistemit (Max. system voltage)	kV rms	
	Tensioni nominal (Rated voltage)	kV	
	Tensioni flashover per frekuencen e fuqise (Power frequency flashover Voltage)		
	• ne te thate (Dry)	kV crest	
	• ne lageshtire (Wet)	kV crest	
	Tensioni kritik impulsiv flashover (Critical impulse flashover voltage)		
	• vala positive (Positive wave)	kV crest	
	• Vala negative (Negative wave)	kV crest	
	Qendrushmeria ndaj tensionit me frekuencen e fuqise (Power frequency withstand voltage)		
	• ne te thate (Dry)	kV crest	
	• ne lageshtire (Wet)	kV crest	
	Qendrushmeria ndaj tensionit impulsiv (Impulse withstand voltage)	kV crest	
	Distanca e shkarkimit sipas IEC (Creepage dist. Class as per IEC)	mm	
	Momenti minimal i thyerjes sipas DIN 48113 (Minimum fracture moment acc to DIN 48113) ose ekivalente me to.	kNm	
	Cantilever strength	kN	
	Tension strength	kN	
	Torsion strength	Nm	
	Compression strength	kN	
3	Dimensioned dhe pesha (DIMENSIONS AND WEIGHT)		
	Lartesia (Height)	mm	
	Pesha per nje izolator mbeshtetes komplet (Weight of one complete post insulator)	kg	

Meqen se termat jane teknike, baze do te meret emertimi ne anglisht.

SPECIFIKIME TEKNIKE

KABLLOT AJROR TU ME VETE-MBAJTJE NE TE GJITHE KABLLIN (KABLLO ABC)

SPECIFIKIME TEKNIKE

I. Kabllot Ajror TU me Vetembajtje ne te gjithë kabllin (Kablllo ABC)

Kabllo e TU me percjellesa alumini me vetembajtje perdoren ne rrjetin e energjise elektrike TU per linjat ajrore, per lidhjen e shtepive etj dhe per instalime ne nivelin e tensionit 0.6/1 kV. Vecanerisht ato jane te pershtatshme per tu vendosur ne hapësira te limituara ose ne kryqezime. Tensioni i punes mund ta tejkalojë tensionin nominal deri ne 20 %.

Keta kablllo jane me izolacion XLPE.

1. Te pergjithshme

Kablli XLPE me vetembajtje do te perdoret per linjat e tensionit te ulet.

Do te funizohen kablllo me vetembajtje ne te gjithë kabllin.

Kater percjellesit e aluminit perbehen nga tre fazat dhe percjellesi i neutrit. Seksionet e kabllit jane si me poshte:

- XLPE 4 x 120 mm² 0.6/1 kV Al,
- XLPE 4 x 95 mm² 0.6/1 kV Al,
- XLPE 4 x 70 mm² 0.6/1 kV Al,
- XLPE 4 x 50 mm² 0.6/1 kV Al,
- XLPE 4 x 35 mm² 0.6/1 kV Al,
- XLPE 4 x 25 mm² 0.6/1 kV Al,
- XLPE 4 x 16 mm² 0.6/1 kV Al,

2. Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi ne momentin e dorezimit te mallit te siguroje:

Te dhena teknike sic kerkohen ne specifikime teknike

- Te gjithë test raportet e fabrikes si ne specikimet teknike
- Skicat dhe dimensionet
- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te kene marketim CE

3. Kushtet e sistemit

Te dhenat e sistemit

Tensioni me I larte ne sistem
 Tensioni nominal
 Frekuenca
 Numri I fazeve

Njesia

kV 0.66
 V 230/400
 Hz 50
 No 3 faze/4 percjellesa

Sistemi I tokezimit

Direct ne toke

Kushtet atmosferike

Temperatura maksimale e ambientit	40°C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Lageshtia maksimale relative	80%
Lartesia maksimale nga niveli I detit	1000m

4. Pershkrim, Kerkesa dhe te Dhena

Kablli me katër percjelles përbëhet nga përcjellësa alumini të izoluar të cilët janë gërshetuar në formën e litarit dhe nuk kanë mbulesë të përbashkët. Çdo përcjellës përbëhet nga tela alumini të cilët janë gërshetuar në formën e litarit dhe janë të gjithë të izoluar me një mbulesë polietileni.

Të gjithë këta përcjellës funksionojnë si një i vetëm, duke e shperndare sforcimin në të gjithë gjatësinë e tyre. Përcjellësit jane rezistent ndaj ujit dhe rrezatimit ultraviolet.

Kablli duhet ti rezistojë rrezatimit UV

Te dhena teknike

Numri I dejeve x seksioni ne mm ²	Diametri i jashtem (i perafert)	Rezistenca aktive ne 20oC	Ryma e lejuar (sipas kushteve te punes me poshte)	Qendrushmeria minimale ne keputje e nje percjellesi strand(nje delli)	Pesha (e perafert)
mm ²	mm	Ω/km	A	kN	kg/km
4x16	19	1.91	81	2.80	303
4x25	20	1.2	107	4.17	421
4x35	25	0.868	132	5.78	543
4x50	28	0.641	162	8.45	753
4x70	32	0.443	205	11.32	986
4x95	44	0.320	243	15.60	1358
4x120	48	0.253	295	16.50	1660

Rrymat e lejuara jane per kushtet:

Temperature e ambientit 35 °C
 Temperatura e percjellesit 80 °C
 Shpejtesia e eres 0.6 m/s
 Frekuenca 50 Hz

Sipas Standartit SSH HD 626 S1:1996 A1:1997

KONSTRUKSIONI I PERCJELLESAVE ABC ME VETEMBAJTJE		TE DHENA TEKNIKE
Percjellesat - Te Fazave Alumini; seksioni i formuar me disa percjellesa elementare		Temperatura e lejuar e punes 80°C
Percjellesi - Neutri Alumini; seksioni i formuar me disa percjellesa elementare		Temperatura maksimale e rrymave te lidhjes se shkurter 130°C/5sekonda
Izolimi: Fazat: Material XLPE , ne perputhje me SSH HD 626 1996: A1:1997 type TIX-2 me ngjyre te zeze		Tensioni nominal ne rrymen alternative me frekuence 50Hz $U_0/U=0,6/1kV$
Neutri - material XLPE, ne perputhje me SH HD 626-1 tip TIX-2 me ngjyre te ndryshme nga fazet		Tensioni maksimal gjate regjimit te punes ne rrymen alternative - jo me shume se 1,2 kV
Formimi: te kater percjellesat (te fazave dhe neutrit) jane te thurur ne forme “gersheti” gjate gjithë gjatesise		Testet e provave ne tension te rritur(ne perputhje me stndartin SSH HD 626 S1:1996 A1:1997 - Tensioni i Testimit 4kV AC ose 9.6kV DC Metoda e testimit Sipas standartit SSH HD 626 S1:1996 A1:1997
		Rrezja e perkuljes minimale e “gershetit” te percjellesave - Sipas standartit SSH HD 626 S1 :1996 A1:1997

Kerkesa per ndertimin

Percjellesit e perdredhur duhet te jene me izolim XLPE dhe te projektuara per tension nominal 0.6/1 kV.

Percjellesit(dejet)

Percjellesit duhet te jene te perdredhur ne kah orar. Perdredhja duhet te lejoje ndarjen e lehte te percjellsave gjate shtrirjes dhe ruajtjen e kendit.

Percjellesit duhet te jene me seksion rrethor perbere nga 99.5% alumin I paster dhe duhet te jete klasa II sipas standartit SSH HD .

Vlera e rrymes se vazhduar te kabllove duhet ti referohet temperatures se ambientit prej 35°C te 100% koeficientit te fuqise.

Izolimi

Të gjithë përcjellësit do të jenë të izoluar me XLPE (si me siper) rezistent ndaj rezatimit UV, lehtësisht i ndashëm nga përcjellësi. Mënyra se si hiqet shtresa izoluese e dellit tregohet nga vete prodhuesi

Izolacioni i fazave dhe neutrit do te jene rezistent ndaj rezatimit UV.

Perdredhja

Katër përcjellësit e izoluar të kabllit, të përdredhur së bashku, do të formojnë kabllin e gershetuar. Në këtë rast, tërheqja totale e linjës shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme tek të gjithë përcjellësit.

Shenime

Përcjellësit e izoluar do të shenohen në mënyrë permanente me shkronja te stampuara. Metoda e identifikimit është vendosja e numrave/shkronjave në çdo përcjellës me numra të njëpasnjëshëm 1, 2, 3 për përcjellësit e fazës, me shkronjën N përgjatë gjithë gjatësisë se neutrit.

Përveç shenjave për identifikimin e përcjellësit, përcjellësi i neutrit do të shenohet me emërtimet e mëposhtme:

- Marka e prodhimit
- Standardet e referencës
- Shenimi qe identifikon numrin serial dhe vitin e prodhimit.
- Tensioni i izolimit (1000 V)
- Lloji i materialit izolues
- Logon “OSHEE”
- Markim CE
- Shenimi I gjatesise progresive , qe duhet te filloje me vleren me te madhe meqellim qe gjatesia e kabllit te mbetur ne baraban te kete mundesi per tu lexuar.

Shenimi do të ketë permasa të mjaftueshme për t’u lexuar në raport me diametrin e kabllit. Hapësira ndërmjet dy shenimeve te njepasnjeshme nuk do t’i kalojë 50 cm.

5. Testet

Testet e meposhtme duhet te kryhen sipas kerkesave te standartit SSH HD 626 S1:1996A1:1997

a) Testet Rutine:

Testet e meposhtme rutine duhet te kryhen sipas kerkesave te standartit SSH HD 626 S1:1996A1:1997

1. Matja e rezistences elektrike te percjellesave.
2. Testi i qendrueshmerise per frekuence industriale

b) Testet Speciale:

Testet e meposhtme speciale duhet te kryhen per gjatesi prej 2 km per cdo seksion

1. Ekzaminim i percjellesit
2. Kontroll i dimensioneve

c) Testet Tip

Te gjithë testet tip, elektrike dhe jo-elektrike, te aplikueshme ne kablllo te specifikuar sipas standarteve perkates, duhet te kryhen ne rast se prodhuesi nuk paraqet nje certificate per testet tip per kablllo

6. Standartet

Kabllot do te jene conform standarteve

SSH HD 626 S1:1996:A1:1997 e vijues (si dhe cdo ndryshim qe mund te pesoje ky standart ne te ardhmen)

7. Paketimi dhe transporti

Barabanet e kablllove jane te pakthyeshem.

Barabanet duhet te permbajne nje sasi jo me pak se 500 m secili.

Diametri I barabanit duhet te jete ne madhesi te tille qe kablli te mos humbasi vetite e tij fizike.

Per tu mbrojtur nga lageshtia fundet e kabllit duhet te pajisen me koka kablli me termotkurrije.

Kabllot ajror duhet te mbulohen dhe izoloohen ne menyre te tille qe te mos pesojne ndonje demtim te mundeshem gjate transportit.

Shenimet ne baraban duhet te jene:

- Numri I kontrates,
- Numri I projektit,
- Lloji I kabllit,
- Gjatesia e kabllit,
- Pesha bruto,
- Numri I barabanit.
- Markim CE

8. Kerkesa per instalim

Gjatë montimit, percjellesit nuk duhet të prekin tokën, pasi mund të dëmtohet izolimi dhe, për pasojë është e ndaluar vendosja e tyre në tokë.

Specifikime teknike – kabllot ajror ABC me Vetembajtje ne te gjithë kabllin

Barabani i kabllit duhet te montohet mbi nyjet perkatese(kambaleca), e cila pajiset me frena.Gjatë shtrirjes, rrezja minimale e përkuljes së përcjellësit është 18xD, ku D është diametri I pjeses se jashtme te kabllit në mm.

Instalimi i përcjellësve nuk duhet kryer në temperature më të ulëta se + 5 °C.

	Kabllot ABC (Aerial Cable XLPE 4x mm²)			
1	Te dhena te pergjitheshme (GENERAL DATA)			
1.1	Tipi kabllit (Type of Cable)			
1.2	Prodhuesi (Manufacturer)			
1.3	Standarti aplikuar (Applied standard)			
2	Te dhena (DATA)			
2.1	Rezistenca max. AC/DC e percjellesit (Maximum AC/DC resistance of conductor)			
	@ 20°C	Ω/km		
	@ 70°C	Ω/km		
2.2	Rezistenca minimale e izolacionit (Minimum insulation resistance)			
	@ 20°C	Ω/km		
	@70°C	Ω/km		
2.3	Rryma per kohe te gjate (Continuous rated current)	A		
2.4	Temperature max e lejuar e percjellesit (Max. permissible conductor temperature)	°C		
2.5	Rryma e LSH e lejuar per 1 sek (Permissible 1 sec short circuit current)	kA		
2.6	Temperature korensponduese e percjellesit (Corresponding conductor temperature)	°C		
2.7	Qendrushermeria ndaj tensionit impulsive per kablllo (Withstand impulse voltage level for cable)	kV		
2.8	Tensioni nominal (Rated voltage) U/U ₀	kV		
2.9	Gjatesia e kabllit e nevojshme per testet tip (Length of cable necessary for type testing)	m		
2.10	Diametri i jashtem i kabllit (Overall diameter of finished cable) (State tolerance also)	mm		
2.11	Pesha e kabllit (Weight of finished cable)	kg/km		
2.12	Gjatesia max per nje baraban (Maximum length per drum)	m		
2.13	Rezja minimale e perkuljes se kabllit (Minimum bending radius of cable)	m		

SPECIFIKIME TEKNIKE

KABINE SHTYLLORE ME DY SHTYLLA

KABINE SHTYLLORE ME DY SHTYLLA

1. Pershkrimi

Kabina shtyllore me dy shtylla, ndertohet me shtylla betoni me gjatesi 10 m dhe 9 m per nje ngarkese ne kulm jo me pak se 10 kN. Kabina shtyllore mund të instalohet si një stacion i përkohshëm ose i perhershëm (ne piken e kerkuar) dhe per transformatore shperndares me fuqi 250, 400,630 kVA .

Materialet zgjidhen sipas specifikimeve teknike perkatese ne perputhje me standartet e OSHEE . Te gjitha materialet prej hekuri ose celiku duhet te jene te galvanizuara.

2. Te dhena te pergjitheshme

Tensioni nominal ne TM	kV	6, 10, 20,35
Tensioni me i larte per paisjet	kV	7.2, 12, 24, 40.5
Tempertaura maksimale per llogaritjen e shigjetes se varjes	°C	80
Temperatura mesatare ditore	°C	30
Temperature minimale	°C	-20
Trashesia e akullit ne percjelles	mm	10
Shpejtesia maksimale e eres	m/s	35
Mesataraja e rreshjeve vjetore	mm	1000-1500

3. Parametrat Teknik

Tensioni nominal TM (kV)	6, 10, 20, 35
Tipi i neutrit	i izoluar
Tensioni nominal TU (V)	230/400
Tipi i neutrit	i tokezuar
Frekuenca nominale (Hz)	50
Fuqia e transformatorit (kVA)	250, 400, 630
Gjatesia e shtyllave te betonit (m)	10, 9
Ngarkesa nominale e lejuar ne krye te shtylles (kN)	10, 15
Rryma e lidhjes se shkurter nga ana e TM (kA)	20
Rryma e lidhjes se shkurter nga ana e TU (kA)	20
Numri i linjave ajrore te TM	1
Numuri max. I linjave dalese TU te jashteme (ajrore), ABC, ose kabllore	Max 4

Paneli TU duhet te zgjidhet ne perputhje me numrin e linjave dalese TU.
Mbrotjtja kundër lidhjeve të shkurtëra në transformator realizohet nga siguresat TM.

Kabine Shtyllore me dy shtylla

Mbrojtja e transformatorit nga mbingarkesat dhe lidhjet e shkurtera nga ana e rrjetit TU realizohet nga automati i linjes.

Mbrojtja nga mbitensioni prej shkarkesave atmosferike behet nepermjet shkarkuesave te TM

Per tokezimin perdoret rrjet tokezimi i perbashket per pajisjet elektrike TM e TU, I cili ndertohet me elektroda tokezimi dhe percjelles tokezimi sipas standarteve dhe specifikimeve teknike te OSHEE.

Mbrojtja nga kontakti indirekt realizohet:

Ne TU	shkycje automatike
Ne TM	me tokezim

Mbrojtja nga prekja aksidentale e pjeseve me tension realizohet me anen e lartesisë, ku lartesia e pjeseve me tension nga siperfaqja e tokes duhet te jete jo me vogel se 5.5m.

4. Pajisjet dhe Pjeset Konstruktive

Te gjitha paisjet qe perdoren ne kabinat shtyllore duhet te jene projektuar per ambient te jashtem. Ato do te jene ne perputhje me specifikimet perkatese te OSHEE. Paisjet shoqerohen me test raportet perkatese.

4.1 Paneli TU

Per kabinat shtyllore paneli TU duhet te jete panel per perdorim te jashtem, sipas standarteve dhe specifikimeve teknike te OSHEE

4.2 Transformatori I Fuqise

Per kabinat shtyllore duhet te perdoren vetem transformatore trefazor me vaj per vendosje ne ambient te jashtem sipas standarteve dhe specifikimeve teknike te OSHEE, me tension 6, 10, 20, 35/0.4kV ne perputhje me standartet e rrjetit, me fuqi nominale 250 400,630 kVA.

4.3 Ndaresi, Siguresat dhe Shkarkuesit TM

Per kabinat shtyllore do te perdoren ndares, siguresa dhe shkarkues 6,10, 20, 35 kV sipas standarteve dhe specifikimeve teknike te OSHEE. Zgjedhja e tyre eshte ne varesi te te dhenave te transformatorit te fuqise dhe standartit te rrjetit. Ndaresi eshte i paisur me mekanizmin operues(doreze, shtange)

4.4 Shtylla Betoni te Centrifuguara

Kabine Shtyllore me dy shtylla

Shtyllat e betonit duhet të jete në përputhje me standartet dhe specifikimet teknike të OSHEE. Ngarkesa në majë të shtyllës 10 ose 15 kN përcaktohet në baze të llogaritjeve mekanike të linjes (sipas rastit konkret).

4.5 Konstruksionet

Te gjitha konstruksionet duhet të jene celik me zingim të thellë në të nxehtë. Bazamenti transformatorit duhet të llogaritet që të mbaje një peshe deri 3200 kG.

5. Te Pergjithshme

Zona mbrojtese

Kabina shtyllore mbulon mbrojtjen e saj duke përjashtuar mbrojtjen e rrjetit të TM nga i cili furnizohet me energji elektrike.

Siguria nga zjarri

Kabina shtyllore është një ndarje (nyje) e vecantë për sa i përket mbrojtjes nga zjarri. Ngarkesa e zjarrit në një stacion transformimi të tipit shtyllor me transformator me vaj llogaritet për një kohezgjatje prej 90 minuta.

Distanca nga pjesa e jashtme e transformatorit deri tek ndertimet e tjera duhet të jete me e madhe se 10 m.

Për distanca më të vogla ose në baze të kërkesave të vecanta specifike, për sigurinë e ndertesave në afërsi të saj, hartohet një raport i veçantë i mbrojtjes nga zjarri bazuar në vendndodhjet e veçanta të transformatorëve (kabinave shtyllore). Nëse kabina është e pajisur me një transformator të thatë, vlerat janë të përcaktuara individualisht në raportin e zjarrit, të përgatitur nga projekti.

Sipas ligjit për mbrojtjen nga zjarri kabina shtyllore nuk është një aktivitet ose objekt me rrezik të madh nga zjarri.

Vendndodhja e kabines transformacionit dhe raportet e saj me mjedisin

Kabina shtyllore duhet të jetë e vendosur në mënyrë të tillë që të jete e mundur të kryhet lehtë transporti, montimi, inspektimi dhe mirëmbajtja gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit.


Vendndodhja e kabines shtyllore nuk duhet të rrezikohet nga ujrat sipërfaqesore dhe nëntokesore. Vendndodhja e kabines shtyllore miratohet nga organet kompetente të mbrojtjes nga zjarri. Në rastet kur nuk është e mundur të merret leja e ndertimit për vendndodhjen e kabines shtyllore me transformator me vaj (p.sh. për arsye mjedisore), ose në raste të vecanta në të cilat është e pamundur të gjendet zgjidhje tjetër, atëherë mund të projektohet një kabine shtyllore me transformator të thatë për ambient të jashtëm.

Kabine Shtyllore me dy shtylla

Shenjat e sigurimit teknik



Kabina paiset nga te gjitha anet me pllakata paralajmeruese per rrezikun nga rryma elektrike “Tension i larte – Rrezik vdekje!“, “Mos prek, rrezik vdekje”, Tabela tip me fushe te ujit qe derdhet ne zjarr me shenimin “Te mos shuhet me uje ose me paisje me shkume!“

Skema principiale



Ndertimi i tokezimit(orientues)

Kabine Shtyllore me dy shtylla




Shenim: Rezistenca e tokezimit percaktohet nga llogaritjet konkrete por gjithmone duhet te jete jo me e madhe se 2 ohm. Numri i elektrodave eshte ne funksion te realizimit te kesaj vlere. Gjithmone konturi i tokezimit duhet te jete unazor.

Shenim: Tokezimi i te gjitha paisjeve dhe konstruksioneve metalike duhet te realizohet me shirit tokezimi tip litar cekliku i zinkuar D-12 mm(S=95 mm²) . Cdo paisje lidhet ne menyre te vecante(vec e vec) te percjellesi zbrites i tokezimit qe eshte litar celiku u izinguar S=95 mm².

Numri i elektrodave te tokezimit dhe i bulonave, dadove e ronleveve eshte orientues.

Instalimi i kabines shtyllore

Kabine Shtyllore me dy shtylla



Kabine Shtyllore me dy shtylla

Nr	Emertimi	njes.	sasi
1	Shtylle betoni 9/10 ose 9/15 m/kN	cop	1
2	Shtylle betoni 10/10 ose 10/15 m/kN	cop	1
3	Panel TU	cop	1
4	Konstruksion mbajtes paneli TU	cop	1
5	Trasformator 6,10,20kv 250-400(630)KVA	cop	1
6	Konstruksion mbajtes trasformatori	cop	1
7	Siguresse TM	cop	3
8	Konstruksion mbajtes siguresse	cop	2
9	Shkarkues ventil TM	cop	3
10	Konstruksion mbajtes shkarkuesi	cop	1
11	Ndares TM me sistemin e komandimit	cop	1
12	Konstruksion mbajtes per ndaresin	cop	2
13	Traverse linje	cop	1
14	Izolatore linje(tension string izolator)	cop	3
15	Kokore per 1 izolator per faze, Ø=180,220	cop	1
16	Izolatore linje TM(strain izolator)	cop	3
17	Morseta Al-Al	cop	3
18	Leva e komandimit ndaresit+tubo e aksesore	set	1
	Pllakata paralajmeruese		

Permasat e gropes dhe bazamentit te betonit duhet te jene sipas standarteve dhe specifikimeve teknike me qellim qe te garantojne forcat e lejuara .

Pjeset percjellese te TM nuk duhet te jene me pak se 5.50 m nga siperfaqja e tokes.

Ne pjesen e siperme te tubit PVC, qe sherben per mbrojtjen e kabllit TU per mos depertimin e lageshtise, te perdoret material shkume izoluese.

Detaje dhe permasa te sakta jepen nga projektuesi ne fletet perkatese te projektit, ne funksion te terenit dhe kerkesave te tjera te projektit.

6. Specifikime teknike te detajuara per anen konstruktive

Te pergjitheshme

Te gjitha materialet do te jene te zinguar , me zingim te thelle ne te nxehte .

Standartet

SSH EN 1993-1-1Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-1: Rregullat e përgjithshme dhe rregullat për ndërtesat (Eurocode 3. Design of steel structures General rules and rules for buildings)

Kabine Shtyllore me dy shtylla

SSH EN 1993-1-2 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1- 2: Rregullat e përgjithshme - Projektimi strukturor për zjarrin (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-2: General rules - Structural fire design)

SSH EN 1993-1-4 Eurokodi 3 - Projektimi i strukturave të çelikut - Pjesa 1-4: Rregulla të përgjithshme - Rregulla shtesë për çeliket e paoksidueshëm (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-4: General rules - Supplementary rules for stainless steels)

SSH EN 1993-1-5 Eurocode 3 - Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-5: Elementët strukturor pllakë (Design of steel structures - Part 1-5: Plated structural elements)

SSH EN 1993-1-6 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-6: Rezistenca dhe stabiliteti i strukturave guackore (Eurocode 3 - Design of steel structures - Part 1-6: Strength and Stability of Shell Structures)

SSH EN 1993-1-8 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1- 8: Projektimi i xhuntimeve (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-8: Design of joints)

SSH EN 1993-1-10 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-10: Rezistenca e materialit dhe vetitë nëpërmjet trashësisë (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-10: Material toughness and through-thickness properties)

SSH EN 1993-1-11 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-11: Projektimi i strukturave me komponentë në tërheqje (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-11: Design of structures with tension components)

SSH EN 1993-3-1 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 3-1: Kullat, shtyllat dhe oxhakët - Traret dhe shtyllat (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 3-1: Towers, masts and chimneys - Towers and masts)

SSH EN 1994-1-1 Eurokodi 4: Projektimi i strukturave kompozite çelik dhe beton - Pjesa 1-1: Rregulla të përgjithshme dhe rregulla për ndërtesa (Eurocode 4: Design of composite steel and concrete structures - Part 1-1: General rules and rules for buildings)

SSH EN 1994-1-2 Eurokodi 4: Projektimi i strukturave kompozite çelik dhe beton - Pjesa 1-2: Rregulla të përgjithshme – Projektimi strukturor ndaj zjarrit (Eurocode 4: Design of composite steel and concrete structures - Part 1-2: General rules - Structural fire design)

SSH EN 1998-1 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit – Pjesa 1: Rregulla të përgjithshme, veprimet sizmike dhe rregullat për ndërtesa (Eurocode 8: Design of structures for earthquake resistance - Part 1: General rules, seismic actions and rules for buildings)

SSH EN 1998-5 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit - Pjesa 5: Themelet, strukturat mbajtëse dhe aspekte gjeoteknike (Eurocode 8: Design of structures for earthquake resistance - Part 5: Foundations, retaining structures and geotechnical aspects)

SSH EN 12843 Produkte të parafabrikuara të betonit - Shtyllat dhe traret (Precast concrete products - Masts and poles)

SSH EN 10080 Çelik për përforcimin e betonit - Çelik i përforcuar i saldueshëm - Të përgjithshme (Steel for the reinforcement of concrete - Weldable reinforcing steel – General)

SSH EN 12620 Agregatet e betonit (Concrete aggregate)

SSH EN 1097- 1 Provat për vetitë fizike dhe mekanike të agregateve - Pjesa 1: Përcaktimi i rezistencës ndaj fërkimit (mikro-Deval) Tests for mechanical and physical properties of aggregates - Part 1: Determination of the resistance to wear (micro-Deval)

SSH EN 1097-2 Provat për vetitë mekanike dhe fizike të agregateve - Pjesa 2: Metoda të përcaktimit të rezistencës ndaj copëzimit (Tests for mechanical and physical properties of aggregates - Part 2: Methods for the determination of resistance to fragmentation)

Kabine Shtyllore me dy shtylla

SSH EN 1367- 1 Prova për vetit termike dhe klimaterike të aggregateve - Pjesa 1: Përcaktimi i rezistencës në ngrirje dhe shkrije (Tests for thermal and weathering properties of aggregates - Part 1: Determination of resistance to freezing and thawing)

SSH EN 196- 1 Metoda prove për çimento - Pjesa 1: Përcaktimi i fortësisë (Methods of testing cement - Part 1: Determination of strength)

SSH EN 196- 7 Metoda prove për çimento - Pjesa 7: Metoda për marrjen dhe përgatitjen e mostrave të çimentos (Methods of testing cement - Part 7: Methods of taking and preparing samples of cement)

SSH EN 197-1 Çimento - Pjesa 1: Përbërja, karakteristikat dhe kriteret e konformitetit për çimentot e zakonshme (Cement - Part 1: Composition, specifications and conformity criteria for common cements)

SSH EN 197-2 Çimento - Pjesa 2: Vlerësimi i konformitetit (Cement - Part 2: Conformity evaluation)

SH ISO 1920- 1 Testimi i betonit - Pjesa 1: Marrja e mostrës së betonit të sapo përgatitur (Testing of concrete - Part 1: Sampling of fresh concrete)

SH ISO 1920-3 Testimi i betonit - Pjesa 3: Marrja dhe trajtimi i mostrës (Testing of concrete - Part 3: Making and curing test specimens)

SH ISO 1920-4 Testimi i betonit - Pjesa 4: Rezistenca e betonit të ngurtësuar (Testing of concrete - Part 4: Strength of hardened concrete)

Te gjitha materialet do të jenë në përputhje me dispozitat përkatëse të SSH, IEC, EN ose standardeve të tjera ekuivalente.

Baza ligjore




- Ligji Nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”
- Vendimi i ERE nr.100, date 26.8.2008 “Kodi_Shpërndarjes”
- Vendimi i ERE nr.101, date 2.8.2008 “Kodi_Matjes”
- Vendimi i ERE nr.123, date 24.10.2008 “Kodi_Transmetimit”
- ERE “Per Lidhjet e Reja ne Sistemin e Shpërndarjes”
- “Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik per Impiantet, Instalimet dhe Paisjet Elektrike”
- Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”
- VKM 68 15.2.2001 “Per Miratimin e Standardeve dhe Kushteve Teknike Te Projektimit dhe Zbatimit te Punimeve te Ndertimit”
- Ligji nr.8405, date 17.9.1998 per “Urbanistiken”
- Ligji nr.8402, date 10.9.1998 per “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”
- Ligji Nr. 10 440, dt 7.7.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”
- Ligji Nr.9537 date 18.05.2006 “Per Administrimin e Mbetjeve te Rrezikeshme (i permiresuar me LigjinNr.9890 date 20.03.2008)”
- Ligji nr. 8934, date 5.9.2002 per “Mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 “ Për zonat e mbrojtura ”
- VKM Nr.249, dt 24.04.2003 “Për Miratimin e Dokumentacionit për Leje Mjedisore dhe të Elementeve të Lejes Mjedisore”
- VKM nr 587 date 07.07.2010 “Per monitorimin dhe kontrollin e nivelit te zhurmave ne qendrat urbane e turistike”

Kabine Shtyllore me dy shtylla

a. Traverse Linje	cope	1
b. Qafore M16x310x370	cope	1
c. Rondele d=18mm	cope	2
d. Dado M16	cope	2

2. Konstruksion Mbajtes Ndaresi TM (viz. 2)


(Te gjithë materialet duhet te jene me zincim te thelle ne te nxehte)



e. Traverse	cope	2
f. Qafore M16x420x370	cope	2
g. Rondele d=18mm	cope	4


Kabine Shtyllore me dy shtylla

h. Dado M16 cope 4




3. Konstruksion Mbajtes Shkarkuesi TM (viz. 3)

(Te gjithë materialet duhet te jene me zincim te thelle ne te nxehte)



- | | | |
|-----------------------|------|---|
| a. Traverse | cope | 1 |
| b. Qafore M16x420x370 | cope | 1 |
| c. Rondele d=18mm | cope | 2 |
| d. Dado M16 | cope | 2 |


Kabine Shtyllore me dy shtylla




Kabine Shtyllore me dy shtylla

4. Konstruksion Mbajtes Siguresse TM (viz. 4)

(Te gjithë materialet duhet te jene me zincim te thelle ne te nxehte)




- | | | |
|-----------------------|------|---|
| a. Traverse | cope | 2 |
| b. Qafore M16x420x370 | cope | 2 |
| c. Rondele d=18mm | cope | 4 |
| d. Dado M16 | cope | 4 |



5. Konstruksion Mbajtes Transformator Fuqie (viz. 5)

(Te gjithë materialet duhet te jene me zingim te thelle ne te nxehte)

Kabine Shtyllore me dy shtylla



a. Traverse	profil U 100x10x2780	cope	2
b. Profil L	100x40x4	cope	4
c. Prizhonier	M20x500	cope	4
d. Rondele	d=22mm	cope	8
e. Dado	M20	cope	16
f. Profil I zinguar	U100x800	cope	2
g. Profil I zinguar	U120x150	cope	4
h. Qafore shirit celiku	40x4	cope	2
i. Dado+bullona+rondele	M12	set	6


Per te ritur qendrushermerine e transformatorit, traversat horizontale “U120x55” duhet te fiksohen ne bazament. Pozicioni i tyre duhet te pershtatet sipas transformatorit. Edhe transformatori duhet te fiksohet ne traversat horizontale. Prodhuesi percakton detajet dhe anen konstruktive perkatese.

Kabine Shtyllore me dy shtylla

6. Konstruksion Mbajtes Panel TU (viz. 6)

(Te gjithë materialet duhet te jene me zingim te thelle ne te nxehte)

Bazamenti i panelit TU



a. Traversa	cope	4
b. Prizhoniere St/Zn M16x500	cope	8
c. Prizhoniere St/Zn M12x500	cope	4
d. Rondele d=18 mm	cope	16
e. Rondele d=13 mm	cope	8
f. Dado M16	cope	32
g. Dado M12	cope	16
h. Bullona M12x40	cope	4
i. Dado M12	cope	4
j. Rondele d13	cope	4

Sipas tipit te panelit TU qe do perdoret (qe percaktohet nga projektuesi), prodhuesi percakton permasat dhe detajet e montimit te tij ne bazamentin(traversat) e mesiperm .



SPECIFIKIME TEKNIKE

KABLLI KONCENTRIK(KOAKSIAL) TU 1X6/6 MM2

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. KABLOT KONCENTRIK TU

Kabllo koncentrik duhet te jene conform standarteve dhe specifikimeve te meposhtme.

Materiali eshte projektuar per te punuar ne rrjet ne kushte atmosferike te ndryshme pa u demtuar.

Kabllo duhet te punojne ne kushtet e ndryshimeve te ngarkeses dhe tensionit nga lidhja e shkurter apo ndonje tjeter demtim qe mund te ndodh dhe te siguroje vlerat nominale ne paisje.

Te gjitha materialet e perdorura per prodhimin e kablilit koncentrik duhet te jene cilesia me e mire dhe te pershtatshme per pune ne kushtet e specifikuara me poshte.

Kushtet e sistemit

Te dhenat e sistemit

Te dhenat e sistemit	Njesia	
Tensioni me i larte i sistemit	kV	0.66
Tensioni nominal	V	400/230
Frekuenca	Hz	50
Numri i fazeve	Nr	3 faze/4 percjelles
Sistemi I tokezimit		Solidly grounded

Kushtet atmosferike

Temperatura max.e ambientit	40°C
Temperatura min.e ambientit	-10 °C
Lageshtia max. relative	80%
Lartesia max nga niveli I detit	1000m

1.1 Kerkesa te pergjithshme teknike

Ky specifikim mbulon kerkesat e kabllove koncentrik TU.

Kablli koncentrik eshte projektuar per te punuar ne rrjet ne kushte klimatike te ndryshme.

Kabllo duhet te punojne ne kushtet e ndryshimeve te ngarkeses dhe tensionit nga lidhja e shkurter apo ndonje tjeter demtim qe mund te ndodh dhe te siguroje vlerat nominale.

Kablli koncentrik duhet te permbush standartet SSH EN IEC ose ekuivalentet e tyre.

Rritjet e temperatures duhet te jene conform standartit SSH EN IEC. ose ekuivalentet e tyre.

Te gjitha materialet e perdorura per prodhimin e kabllit koncentrik duhet te jene cilesia me e mire dhe te pershtatshme per pune ne kushtet e specifikuara me poshte.

1.2 KERKESA TE DETYRUESHME

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi ne momentin e dorezimit te mallit te siguroje:

- Te dhena teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat dhe dimensione
- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001

1.3 KERKESA TE HOLLESISHME TEKNIKE

Kablli I kerkuar duhet te jete kabell me percjelles bakri koncentrik me seksion 6 mm^2 , me izolim PVC. Mbi izolimin PVC eshte vendosur nje shtrese percjellese koncetrike e perbere nga nje numer percjellesish bakri , e cila nga ana e saj rrethohet nga nje shirit flete bakri e holle. Shtresa e dyte percjellese e ka seksionin po 6 mm^2 dhe eshte e izoluar me nje shtrese te jashtme PVC. Kablli koncetrik duhet te jete I pershtatshem per perdorim te jashtem dhe te brendshem , si dhe per tu instaluar direkt brenda murit. Kablli duhet ti rezistoje rezatimit UV dhe te mos lejoje perhapjen e zjarrit



Kablli koncetrik do te perdoret per furnizimin e abonenteve nje fazore.

Ndertimi i kabllit koncentrik duhet te jete si me poshte :

- Percjelles bakri , qendror, rrethor
- Izolim me polivinil klorid (PVC)
- Veshja e brendeshme PVC
- Percjelles bakri koncentrik i perbere nga tela bakri
- Shirit bakri spirale hapur
- Shtrese e jashtme prej polivinil kloridi (PVC) me ngjyre te zeze

Ilustrimi

(ilustrimi dhe dimensioned jane orientuese)



Te dhena teknike

Pershkrim	Njesia	Vlerat e kerkuara
Tensioni nominal U_0/U	kV	0.6/1
Frekuenca	Hz	50
Materiali I percjellesit		baker
Seksioni I percjellesit qendror	mm ²	6
koncentrik	mm ²	6
Rryma e lejuar ne ajer (30 °C)	A	40
Rezistenca Max. D.C. ne 20 °C	Ohm/km	3.08
Qendrushmeria ndaj rrymes LSH ne 1 sek	kA	0.7
Temperatura me e ulet e shtrirjes	°C	-5
Temperatura max. e punes	°C	70
Temperatura max. per L.SH max. 5sek.	°C	160
Tensioni I proves AC	kV	3.5
Materiali I izolimit		PVC
Materiali I mbuleses se jashtme		PVC
Diametri i jashtem i perafert i kabllit	mm	12
Pesha orientuse e kabllit	kG/km	245

1.4 Testimet

Testet duhet te kryhen sic specifikohet ne standartet SSH EN IEC 60228, SSH EN IEC 60230, SH IEC 60502-1, SSH EN 60811, SSH EN 60885 etje.ose ekuivalente te tyre.

1.5 Shenim

Kablli koncentrik I tensionit te ulet duhet te jete shenuar me simbole te stampuara.
Per me teper ne kabllin koncentrik duhet te jene shenimet e meposhtme.

- OSHEE
- Marka e prodhuesit
- Standartet referuese
- Shenimi qe bent e mundur identifikimin e markes se prodhuesit dhe vitin e prodhimit
- numri, seksioni dhe materiali I percjellesit
- tensioni I izolimit (1000 V)
- lloji I materialit te izolimit
- markim CE
- Shenimi I gjatesise progresive , qe duhet te filloje me vleren me te madhe meqellim qe gjatesia e kabllit te mbetur ne baraban te kete mundesi per tu lexuar.

Shenimi do të ketë permase të mjaftueshme për t'u lexuar në raport me diametrin e kabllit. Hapësira

ndërmjet dy shenimeve të njëpasnjëshme nuk do t'i kalojë 50 cm.

1.6 Standartet

Kabllo duhet të prodhohen sipas standarteve të mëposhtme SSH, EN, IEC ose ekuivalentet e tyre.

SSH IEC 60502-1 – “Kabllot me izolacion PVC për tension të rrjetit deri 1kV”

IEC 60227 - “kabllot me izolim PVC me tension nominal deri dhe përfshirë 450/750 V”

SSH EN IEC 60228 - “Percjellesit e kabllit”

SSH EN IEC 60230 - “Testet me impulse të kabllave dhe aksesoret e tyre”.

SSH IEC 60724 - “Udhëzim mbi limitin e temperaturës në lidhje të shkurtër në tension nominal që nuk e tejkalon 0,6/1,0kV”.

SSH EN 60811-202:2012+AMD1:2017 CSV Kabllot elektrikë dhe optikë - Metodën e provës për materialet jo metalike - Pjesa 202: Teste të përgjithshme - Matja e trashësisë së mbështjelljes jo metalike
SSH EN 60885 - “Metodat e testimit elektrik të kabllit”

S SH HD 626 S1:1996: Kabllot ajror të shpërndarjes me tension të vlerësuar $U_0/U(U_m)$: 0,6/1 (1,2) kV

S SH HD 626 S1:1996/A1:1997

S SH HD 626 S1:1996/A2:2002

S SH HD 605 S2:2008: Kabllot elektrik - Metodën shtesë të provës

S SH HD 308 S2:2001 Identifikimi i berthamave në kabllot dhe kordonet fleksibel

S SH HD 361 S4:2020 Sisteme për projektimin e kabllave

S SH EN 50565-1:2014: Udhëzues për tu përdorur për kabllot me një tension të vlerësuar që nuk e kalon 450/750 V (U_0/U) - Pjesa 1: Udhëzim i përgjithshëm

S SH EN 50565-2:2014 Udhëzues për tu përdorur për kabllot me një tension të vlerësuar që nuk e kalon 450/750 V (U_0/U) - Pjesa 2: Udhëzim specifik i lidhur me llojet e kabllave të EN 50525

S SH HD 603 S1:1994: Kabllot të shpërndarjes me tension të vlerësuar 0,6/1 kV

S SH HD 603 S1:1994/A1:1997

S SH HD 603 S1:1994/A2:2003

S SH HD 603 S1:1994/A3:2007

S SH HD 604 S1:1994: Kabllot e fuqisë 0,6/1 kV dhe 1,9/3,3 kV me performancë speciale ndaj zjarrit për përdorim në stacionet elektrike

S SH HD 604 S1:1994/A1:1997

S SH HD 604 S1:1994/A2:2002

S SH HD 604 S1:1994/A3:2005

S SH HD 605 S3:2019: Kabllot elektrik - Metodën shtesë të provës

S SH HD 627 S1:1996/A1:2000 Kabllot shumëberthamëshe dhe shumëpalëshe për instalimin nëntokësor dhe mbetokësor

S SH HD 627 S1:1996/A2:2005

S SH EN 50363-0:2011 Materialet e izolimit, mbulueset dhe veshjet për kabllot e energjisë me tensionin të ulët – Pjesa 0: Paraqitje e përgjithshme

S SH EN 50363-3:2005: Materialet e izolimit, veshjet dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 3: Materialet elektroizoluese prej PVC-je

S SH EN 50363-4-1:2005: Materialet e izolimit, veshjet dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 4-1: Materialet veshëse prej PVC-je

- S SH EN 50363-4-2:2005: Materalët e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 4-2: Materalët mbuluesë prej PVC-je
- S SH EN 50395:2005: Metodët elektrike të testimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët
- S SH EN 50396:2005: Metodët jo elektrike të testimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët
- S SH EN 60228:2005: Konduktoret e kabllave të izoluar
- S SH EN 60719:1993: Llogaritja për kufijtë e poshtëm dhe të sipërm për permasat e jashtme mesatare të kabllave me përcjellës rrethorë prej bakri dhe tensionet e vlerësuar mbi dhe duke përfshirë 450/750 V.
- S SH EN 60754-1:2014: Prova mbi gazetë e çliruar gjatë djegies së materialeve nga kabllot - Pjesa 1: Përcaktimi i përmbajtjes së gazit acid halogjen
- S SH EN 60811-100:2012: Kabllot elektrikë dhe kabllot me fibra optike - Metodët e provës për materialet jo-metalike - Pjesa 100: Testet përgjithshme
- S SH EN 60811-201:2012: Kabllot elektrikë dhe kabllot me fibra optike - Metodët e provës për Materialet jo-metalike - Pjesa 201: Provat e përgjithshme - Matja e trashësisë së izolimit
- S SH EN 60811-203:2012: Kabllot elektrikë dhe kabllot me fibra optike - Metodët e provës për materialet jo-metalike - Pjesa 203: Provat e përgjithshme - Matja e permasave tërësore
- S SH EN 60811-301:2012: Kabllot elektrikë dhe kabllot me fibra optike - Metodët e provës për materialet jo-metalike - Pjesa 301: Provat e përgjithshme -Matja e konstantes dielektrike të përberjeve mbushëse në 23 °C
- S SH EN 60811-402:2012: Kabllot elektrikë dhe kabllot me fibra optike - Metodët e provës për materialet jo-metalike - Pjesa 402: Provat të ndryshme - Provat e përthithjes së ujit
- S SH EN 60811-405:2012: Kabllot elektrikë dhe kabllot me fibra optike - Metodët e provës për materialet jo-metalike - Pjesa 405: Provat të ndryshme - Prova e stabilitetit termik për izolimet me PVC dhe veshjet prej PVC

1.7 Identifikimi dhe paketimi

Kablli koncentrik duhet të mbledhet në barabane me gjatësi jo më pak se 1000m. Barabanet nuk janë të rikthyeshëm.

Në secilin baraban duhet të shënohet :

- Lloji i kabllit
- Gjatësia e kabllit
- Emir i prodhuesit
- Viti i prodhimit
- Pështetja brutë
- Numri i barabanit
- Markim CE

Technical Data
Sheet

LV Concentric Cable

No.	Type	Unit	Data
1	Prodhuesi (Manufacture)		
2	Tipi (Type)		
3	Vendi origjines (Country of origin)		
4	Prodhimi standart (Manufacture standard)		
5	Kabell fuqie nje fazor me izolacion PVC (Single core power cable with PVC insulation)		
6	Percjelles bakri koncentrik (Concentric copper conductor)		
7	Seksioni veshjes se jashtme PVC (PVC outer sheath cross section)	mm ²	
8	Per perdorim te brendshem dhe te jashtem (Indoor and outdoor use)		
9	Ndertimi (Construction):		
10	Percjelles bakri rethor (Copper conductor, circular;		
11	Izolacion PVC (Insulation of polyvinyl chloride (PVC));		
12	Veshje e brendeshme PVC (Inner sheath of PVC;)		
13	Percjelles bakri koncentrik i perbere nga tela bakri (Concentric copper conductor consisting of copper wires;)		
14	Shirita bakri si tela kontakti (Copper tape as a contact wire;)		
15	Veshje e jashtme PVC e zeze (Outer sheaths of polyvinyl chloride (PVC) in black.)		
16	Shenime mbi mbulesen e jashtme (Over sheath marked)		
17	Tensioni nominal (Rated voltage) U ₀ /U	kV	
18	Frekuenca (Frequency)	Hz	
	Materiali percjellesit (Conductor material)		
19	Madhesia: Size: of Conductor	mm ²	
20	of concentric conductor	mm ²	
21	Rryma e lejuar (Current carrying capacity:ne toke (in ground)	A	
22	Ne ajer (in air)	A	
23	Rezistenca max ne DC ne 20 °C (Max. D.C. resistance at 20 °C)	Ohm/km	
24	Rryma e LSH per 1 sek.(1 sec. short circuit current☺)	kA	
25	Temperatura me e ulet e vendosjes (Lowest laying temperature)	°C	
26	Temperatura e lejuar e percjellesit (Admissible conductor temper)	°C	
27	Temperatura e lejuar per LSH e percjellesit (Admissible short circuit temper – conductor)	°C	
28	Tensioni AC i testimit (AC testing voltage)	kV	
29	Materiali izolacionit (Insulation material)		
30	Materiali veshjes se jashtme (Outer sheath material)		

Me gene se termat jane teknike, baze do te jete emertimi ne anglisht.





SPECIFIKIME TEKNIKE

KABLLLOT E TM 20KV

KABLOT E FUQISE 20 KV

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME

1.1 Te pergjithshme

Te gjithë kabllot nentokesor te fuqise jane projektuar qe te jene te sigurt ne kushte klimatike te ndryshme pa pesuar demtime.

Materialet duhet te jene te sigurta edhe kur jane ne ngarkese , nen tension apo nen veprimin e lidhjes se shkurter apo avarive te tjera qe mund te ndodhin ne system, ato duhet te sigurojne dhe punojne ne kushte optimale.

1.2 Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi ne momentin e dorezimit te mallit te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhena teknike sic kerkohen ne specifikimet teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes si ne specifikimet teknike
- Skicat dhe dimensioned
- Te kene marketim CE

1.3 Kushtet e sistemit

Te dhena per sistemin

Specifikime	Unit	Sistemi 20 kV
Tensioni nominal i sistemit	kV	20
Tensioni me i larte I sistemit	kV	24
Frekuenca e sistemit	Hz	50
Numri I fazeve		3
Sistemi I tokezimit		I izoluar
Rryma maksimale per lidhje te shkurter ne/1 sek	kA	20

Kushtet atmosferike

Temeperatura maksimale e ambientit	40 °C
Temperatura ditore mesatare	30 °C
Temeperatura minimale e ambientit	-10 °C
Temeperatura maksimale ne siperfaqen e ekspozuar nga dielli	60 °C
Lageshtia relative maksimale (toke)	95 %
Lageshtia relative maksimale (ajer)	80 %
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	<1000 m

Testet fizike dhe elektrike duhet te jene ne perputhje me standartet SSH ,EN, IEC ose ekuivalentet e tyre. Materialet duhet te jene sipas standartit ISO 9001 ose nje standart me i avancuar.

1.4 Furnizimi dhe sherbimet

Kontraktuesi duhet te perfshije me materialet ,skicat ,testimin ,prodhimin, testet dhe transportin ne magazine.

- **Kabllot e fuqise TM 20kV**

Te gjitha furnizimet duhet te jene konform specifikimeve teknike.

1.5 Standartet

Projektimi, materialet, prodhimi dhe testimi I te gjitha puneve duhet te plotesoje kushtet sipas standarteve SSH EN IEC te permendura dhe ne Specifikimet Teknike ose ekuivalentet e tyre.

.

1.6 Inspektimet dhe testet e fabrikes

Testet duhet te kryhen ne fabrike ose ne nje laborator te pershtatshem sipas te dhenave ne specifikime teknike.

Rezultati I te gjitha testeve do te regjistrohet ne test reportet qe permbajne te dhena specifike.

.

2. SPECIFIKIME TEKNIKE TE DETAJUARA

KABLLLOT E FUQISE TM 20 KV

1. Pershkrim,kerkesa dhe te dhena

Do te furnizohen kabllot 1-fazor me percjelles te perdredhur alumini(stranded), me presim tre-shtresor (ekrani gjysempercues mbi percjelles, izolimi dhe ekran gjysempercues mbi izolim duhet te prodhohen ne nje proces te vetem pune), izolimi prej materiali XLPE, ekran bakri, shtrese e jashtme polietileni PE, mbulesa PVC dhe qe nuk lejon perhapjen e zjarrit , te pershtatshme per perdorim ne rrjetin trefazor 20kV.

Ne kushte normale shfrytezimi, kablli me izolacion XLPE punon me temperature maksimale te percjellesit 90 °C.

Te dhena teknike S=240 mm²

Lloji	Kebell Al nje dejesh me izolacion XLPE dhe veshje PE+PVC	
Tensioni nominal U_0/U	kV	12/20
Vlera maksimale e tensionit (U_m)	kV	24
Vlera nominale e tensionit impulsive qe duron	kV	125
Tensioni qe duron ne frekuence te fuqise 50 Hz	kV	50
Numri I fazeve		1
Frekuenca	Hz	50
Materiali ipercjellesit		Alumin
Madhesia e percjellesit	mm ²	240
Materiali izolues		XLPE
Shtresat e gjysempercjesit (metodat e aplikimit) - Siper percjellesit - Siper izolimit		I stampuar I stampuar
Mbulesa metalike	mm ²	≥ 25 (baker)
Materiali I mbuleses se jashtme		PE+PVC
Mbrojtja kunder lageshtise		Gjatesor I pa pershkrushem nga uji
Rryma e lejuar per temperature te percjellesit 65 °C /90 °C, per shtrirje ne toke me vendosje ■ ■ ■	A	350/420
Rryma e lejuar per temperature te percjellesit 65 °C /90 °C, per shtrirje ne toke me vendosje ■ ■ ■	A	370/445
Rezistenca maksimale ne 20 °C	ohm/km	0.125

Te dhena teknike S=185 mm²

Type	Kebell Al nje dejesh me izolacion XLPE dhe veshje PE+PVC	
Tensioni nominal U_0/U	kV	12/20
Vlera maksimale e tensionit (U_m)	kV	24
SSH EN IEC 62053-21 Pajisje matëse të energjisë elektrike - Kërkesa të veçanta - Pjesa 21: Matësit statik për energjinë aktive AC (klasat 0.5, 1 and 2)

SSH EN IEC 62053-22 Pajisje matëse të energjisë elektrike - Kërkesa të veçanta - Pjesa 22: Matësit statik për energjinë aktive AC (klasat 0.1S, 0.2S dhe 0.5S)

SSH EN IEC 62053-23 Pajisje matëse të energjisë elektrike - Kërkesa të veçanta - Pjesa 23: Matësit statik për energjinë reaktive (klasat 2 dhe 3)

SSH EN 62053-31 Pajisje matëse e elektricitetit (a.c.) - Kërkesat e veçanta - Pjesa 31: Pajisjet e prodhimit të dridhjeve për matjet elektromekanike dhe elektronike (vetëm dy kabllorë)

SSH EN 62053-52 Pajisjet matëse të elektricitetit (AC) - Kërkesa të veçanta - Pjesa 52: Simbolet
SSH EN 62053-61 Pajisje matëse e elektricitetit (a.c.) - Kërkesat e veçanta - Pjesa 61: Kërkesat për konsumin e energjisë dhe kërkesat për tensionin
SSH EN 62054-21 Matja e energjisë elektrike të rrymës alternative - Kontrolli i ngarkesës dhe tarifës - Pjesa 21: Kërkesa të veçanta për çelësat kohorë
SSH EN 62056-21 Matja e elektricitetit - Shkëmbimi i të dhënave për leximin e kompjuterave, kontrollit të tarifave dhe të pagesave - Pjesa 21: Shkëmbimi i të dhënave drejtpërdrejt në lokal
SSH EN 62056-42 Matja e elektricitetit - Shkëmbimi i të dhënave për leximin e kompjuterave, kontrollit të tarifave dhe të pagesave - Pjesa 42: Shërbimet dhe procedurat me shtresa fizike për shkëmbimin e të dhënave me ndihmen e lidhjes asinkrone
SSH EN 62056-46 Pajisjet për matjen e energjisë elektrike - Shkëmbimi i të dhënave për leximin e kompjuterave, kontrollit të tarifave dhe të pagesave - Pjesa 46: Shtresa lidhëse që përdorin protokollin HDLC
SSH EN IEC 62056-5-3 Shkëmbimi i të dhënave të matjes së energjisë elektrike - Libraria DLMS®/COSEM - Pjesa 5-3: Shtresa e aplikacionit DLMS/COSEM
SSH EN 62056-6-1 Shkëmbimi i të dhënave të matjes së elektricitetit - Libraria DLMS/COSEM - Pjesa 6-1: Sistemi i identifikimit të objektit (OBIS)
SSH EN 62056-6-2 Shkëmbimi i të dhënave të matjes së elektricitetit - Libraria DLMS/COSEM - Pjesa 6-2: Klasat e ndërfaqes COSEM
SSH EN 55032/CISPR32 – Percakton (klasi B) emetimet radio-elektrike në diapazonin > 150kHz
Direktiva e perputhshmerise Elektromagnetike 2014/30/EU. Pajtueshmeria eshte demonstruar nga konformiteti me SSH EN IEC 62052-11 dhe SSH EN IEC 62053-21.
Direktiva Europiane 2014/32/EU per matje dhe instrumentim (Measurement Instrument)
Prova ciklike ne lageshti me nxehtesi SSH EN IEC 62052-11, seksioni 6.3.3
Testi ne uje me kripe sipas SSH EN IEC 60068-2-11

Garancia

Prodhuesi duhet të sigurojë furnizimin e matësave dhe aksesoreve të tyre në përputhje me të gjitha specifikimet dhe kërkesat e këtij standardi.
Matësit duhet të dorëzohen pa defekte, të kenë karakteristikat e kërkuara dhe të mos paraqesin gabime që reduktojnë vlerat matëse ose performancën e tyre.
Periodha minimale e garancisë është 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e dorëzimit.
Koha maksimale për eliminimin e defekteve gjatë periudhës së garancisë përcaktohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune, ose brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve pune në rast zëvendësimi të matësit.

Dokumentacioni

Furnizuesi duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Përshkrim i saktë i tipit, prodhuesit dhe vendit të origjinës
- Përshkrim teknik me parametra dhe aksesore
- Përshkrim i detajuar i nivelit të sigurisë, mbrojtje kundër ndërhyrjeve të paautorizuara
- Pesha totale dhe jetëgjatësia
- Instruksione për përdorim, montim dhe mirëmbajtje
- Përshkrim i sistemit të menaxhimit të cilësisë së prodhimit, provat dhe certifikatat përkatëse
- Kërkesa për transportim dhe lëvizje
- Raportet e testeve me listën bashkëngjitur

- Certifikata të testeve të pavarura
- Të gjitha dokumentet teknike, përshkrimet e sigurisë, mbrojtja kundër ndërhyrjeve, instruksionet për përdorim, mirëmbajtje dhe montim duhet të jenë në gjuhën shqipe

- MINIAUTOMATET TRE FAZORE TU

1. Kërkesa te pergjitheshme

Ky specifikim paraqet kushtet e pergjitheshme teknike per blerjen dhe pranimin e miniautomateve TU tre fazore (Limitaret), te cilet perdoren ne rrjetat e tensionit te ulet si celesa, si paisje mbrojtese.

Paisja duhet te jete konform standarteve SSH,EN,IEC ose ekuivalenete te tyre.

Pajisjet duhet të ndërtohen për të siguruar funksionimin e sigurve, mirembajtje, mbrojtjen ne punë dhe do të shënohet me një tregues të dukshem të sigurisë.

Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



2. Kërkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi ne momentin e dorezimit te mallit te siguroje dokumentat e meposhtme.

- Certifikat e fabrikes ISO 9001
- Te dhena teknike sic kerkohen me poshte
- Karakteristikat e komutimit per automatet

3. Kushtet e sistemit

Te dhena per sistemin	Njesia	
Tensioni me I larte I sistemit	kV	0.66
Tensioni nominal	V	400
Frekuenca	Hz	50
Numri I fazeve	Nr	3 faze/4 percjelles
Sitemi I tokezimit		Direkt ne toke

Kushtet atmosferike

Temperatura maks. e ambientit	40°C
Temperatura min. e ambientit	-10 °C
Lageshtia relative maksimale	80%
Lartesia maks. mbi nivelin e detit	1000m
Ndotja	mesatare

4. Pershkrim, Kerkesa dhe te Dhena

Ky specifikim mbulon kerkesat per miniautomate te TU nje dhe tre fazore (Limitaret) me qellim qe te perdoren ne rrjetat e tensionit te ulet si celesa dhe si element mbrojtjes.

Miniautomatet e TU nje dhe tre fazore (Limitaret) TU duhet te jene per perdorim te brendeshem.

Miniautomatet tre fazore

1	Numri I poleve		3
2	Ryma nominale ne 30°C, In	A	10,16(sipas kerkeses)
3	Rryma max qe nuk shkakton ckycje (Int)	A	1.13
4	Kapaciteti I ckycjes se lidhjes se shkurter	KA	6
5	Tensioni nominal	V	400
6	Tension I izolimit	V	500
7	Frekuenca	Hz	50
8	Numri i cikleve mekanike te punes		20000
9	Numri I cikleve elektrike te punes		8000
10	Kurba e komutimit		B,C (sipas skemes)

5. Standartet e references

SSH EN 60898-1 Pajisje ndihmëse elektrike - Ndërprerësit e qarkut për mbrojtjen nga mbirryma për instalimet shtëpiake dhe të ngjashme me to - Pjesa 1: Ndërpresit për funksionim në qarkun e rrymës alternative (Electrical accessories - Circuit-breakers for overcurrent protection for household and similar installations - Part 1: Circuit-breakers for a.c. operation)

SSH EN 60947-2 Pajisjet shpërndarëse dhe të kontrollit të tensionit të ulët – Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut (Low-voltage switchgear and controlgear – Part 2: Circuit-breakers)

SSH EN 50274:2002: Tërësia e pajisjeve shpërndarëse të tensionit të ulët - Mbrojtja nga goditja elektrike - Mbrojtja nga kontakti i drejtpërdrejtë i paqëllimshëm me pjesët e rrezikshme nën tension

SSH EN 50274:2002/AC:2009: Tërësia e pajisjeve shpërndarëse të tensionit të ulët - Mbrojtja nga goditja elektrike - Mbrojtja nga kontakti i drejtpërdrejtë i paqëllimshëm me pjesët qe perbejne rezik per jeten.

6. Ndertimi dhe materialet

Limitatorët (automatët) e ofruar duhet të jenë të serisë standarte të prodhimit aktual dhe duhet të kenë siguri në përputhje me specifikimet e dhena.

Limitatorët duhet të jenë të tipit që montohet në shinë dhe duhet të funksionojnë sipas kurbës së komutimit tip B.

Limitatorët brenda boksit individual duhet të jenë të vendosur në mënyrë të tillë, që të lejojnë manipulimin e tij nga konsumatori, dhe njëkohësisht të parashikojë eliminimin e ç'do mundësie vjedhjeje të energjisë elektrike.

7. Tests

Llojet e testeve do të kryhen në përputhje me standartet SSH EN 60898 dhe SSH EN 60947

8. Sherbime

Furnizuesi duhet të sigurojë 3 paketa nga dokumentat e mëposhtme:


- Karakteristikat e komutimit
- Vizatimet strukturore,
- Manualin e përdorimit

Aneks 1

Skema Nr.1

Skema elektrike e panelit të tensionit të ulët me katër dalje

SKEMA E PANELIT TU KABINES



SHENIME:

Ne kete flete paraqitet skema elektrike njevijeshe e panelit TU me kater dalje, per ambient te brendshem, te kabinave TM/TU.

Paneli eshte i paisur me transformatore rryme kryesore 800/5 per gjithe ngarkesen e kabines si dhe transformatore rryme 250/5 per cdo dalje. Montimi i transformatoreve te rrymes per daljet eshte opsional (kjo percaktohet sakte ne kerkese).

Paneli eshte i paisur edhe me mates bilanci kryesor.

Per mbrojtjen e qarqeve te tesionit qe furnizojne matesat e vendosur ne panelin e matjes dhe ne vet panelin TU, eshte parashikuar nje miniautomat(limitator) trefazor 10A, 400V, klasa C.

Per mbrojtjen e qarqeve te ndricimit dhe prizave, eshte parashikuar nje miniautomat(limitator) trefazor 10A, 400V, klasa B

Per lidhjen e matesave do te perdoren kablllo Cu 4x2.5 mm² per qarqet e tesionit dh kabell Cu6x2.5 mm² per qarqet e rrymes.

Per prezencen e tesionit ne hyrje eshte parashikuar edhe llamba LED me indikacion per te tre fazet.

Temperatura brenda boksit ne pjesen e sipërme te tij te mos jete me shume se 60 °C

Paneli duhet te mbyllet me dryn.


Paneli duhet te kete hapësire rezerve per montimin ne prespektive edhe te nje automati tjetër, per nje dalje tjetër rezerve, si dhe per transformatoret e rrymes perkates.

Per ilustrim eshte mare skema e panelit per trasformator fuqie 400 kVA.


Te gjitha materialet perberese te panelit do te jene ne perputhje me specifikimet teknike te OSHEE.

Gjate zbatimit te punimeve te zbatohen te gjitha kushtet teknike te OSHEE.

Skema per variantin me tre dalje




Skema per variantin me dy dalje




Kompozimi panelit duhet te behet ne menyre te tille qe te respektohen standartet e panelit ne teresi, standartet e punes se paisjeve, sigurimi teknik e tje. Kujdes duhet te tregohet me ventilimin ne menyre qe temperatura maksimale ne pjesen e sipërme te panelit te mos kaloje 60 °C.

Gjerësia e panelit prej 880-900 mm duhet te mbetet e pa ndryshueshme.

Varianti perfundimtar i prodhimit te panelit do te vendoset pas miratimit nga ana e bleresit.



Per trasformator 160 KVA dhe trasformator 250 KVA



Per trasformator 400 KVA dhe trasformator 630 KVA

Dimensionet me sipër janë orientuese.

Gjerësia 880 mm është e pandryshueshme.

Paneli do të ndërtohet sipas skemës me sipër.

Temperatura në pjesën e sipërme të panelit nuk duhet të kalojë 60 °C

Ai duhet të përmbajë edhe një hapësirë për vendosjen e paisjeve për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike, mates smart 230/400V, 5A si dhe paisjet për komunikim me sistemin.

Varianti përfundimtar i prodhimit të panelit do të vendoset pas miratimit nga ana e blerësit.



SPECIFIKIMET TEKNIKE

PLLAKATA PARALAJMERUESE

Pllakatat e perhereshme paralajmeruese

Ilustrim



- 1.TENSION I LARTE!
RREZIK VDEKJE!
- 2.NDAL!
TENSION I LARTE!
- 3.MOS PREK !
REZIK VDEKJE!

Permasat (28x21) cm.
Sfondi i verdhe.Shkronjat e zeza.
Korniza e kuqe, gjeresia 10m/m.

Ne dy tllakatat e para shtohet shigjeta e kuqe.
Pllakata e trete , kur plotesohet me shenjen rrezik vdekje vendoset ne shtyllat e linjave ajrore.
Materiali eshte aliazh alumini ose sipas kerkeses.
Te gjitha tabelat, kur jane aliazh alumini, kane ne kater cepat vrima me diameter 2 mm per fiksim.


SPECIFIKIMET TEKNIKE

SHIRIT PARALAJMERUES KABLLI NENTOKESOR

SHIRITI PARALAJMERUES NEN TOKE

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Peershkrimi:

Shiriti paralajmerues nen toke perdoret per te paralajmeruar pereth prezences se kablllove dhe tubave elektrike nen toke. Ata jane 100% elastik. Shiriti paralajmerues nen toke duhet te kete logon "OSHEE KABELL ELEKTRIK". Hapesira midis fundit te " tekst" dhe fillimit te " tekst" eshte 50 cm.

Ngjyra dhe teksti duhet te jene rezistente ndaj agjenteve atmosferike dhe elementeve alkaline dhe acideve ose elementeve te tjere nentokesore.

Te dhena teknike

Materiali	Poletilen me densitet te ulet (LDPE)
Ngjyra	sfond i kuq dhe teksti ngjyre te zeze
Elasticiteti	100%
Rezistent ndaj agjenteve alkaline	
Rezistent ndaj acideve nentokesore	
Tekstet te pa fshirshme per cdo arsyje	
Gjeresia e shiritit (mm)	150
Lartesia e tekstit (mm)	50
Gjatesia (m)	100-200-250-500 (sipas kerkeses)

Standartet

S SH EN 50520 Pllaka mbuluese dhe shirta mbulues per paralajmerimin e vendndodhjes dhe mbrojtjes te kablllove te mbuluar ose te tubave te mbuluar ne instalimet nentokesore

Amballazhimi

Amballazhimi behet ne kuti kartoni



SPECIFIKIME TEKNIKE

SHKARKUESIT METAL-OKSID TE TM 10KV

SHKARKUESIT METAL-OKSID TE TM 10KV


1. Te pergjithshme

Ky specifikim mbulon kerkesat per prodhimin, furnizimin, testimin dhe shperndarjen e shkarkuesave metal-oksidi te TM 10kV, qe perdoren per mbrojtjen e linjave elektrike te shperndarjes.

Ky specifikim perfshin::

- Shkarkuesit metal-oksidi te TM 10 kV

Ilustrimi



1. Varistori ZnO, (Oksid Zinku)
2. Veshja prej silikoni Bowthorpe silicone housing
3. Struktura rezistente ndaj zjarit
4. Bazamenti I perbere nga aliazhi alumini /Pjesa fiksuse prej celiku te pa ndryshkshem

2. Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi ne momentin e dorezimit te mallit te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhenat teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes si ne specifikimet teknike
- Skicat me dimensione
- Manual perdorimi

3. Kushtet e Sistemit

	Specifikime	Njesia	Vlera
1	Tensioni nominal ne sistem	kV	10
2	Tensioni me I larte ne sistem	kV	12
3	Frekuenca e sistemit	Hz	50
4	Numri I fazeve	Jo	3 faze
5	Sistemi I tokezimit		I izoluar

b	Kushtet atmosferike	
1	Temperatura maks. e ambientit	40°C
2	Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
3	Lageshtia relative maks	80%
4	Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	1000m
5	Ndotja	mesatare

4. Pershkrimi, Kerkesa, Te dhena

Shkarkuesit metal-oksid te TM 10kV prodhohen duke perdorur Varistor prej oksid Zinku ZnO , te cilet kane karakteristika te mira termike.

Zemra e shkarkuesave elektrike duhet te jete me disqe me oksid zinku , ndersa veshja e jashtme prej polimeresh.Te gjitha pjeset metalike ne ajer duhet te jene te zinkuara ne te ngrohte, çelik i pandryshkshem ose derdhje alumini. Materiali i rezistoreve duhet te jete prej Oksid Zinku.

Trupi i shkarkuesit duhet te jete i ndertuar me materiale polimere dhe te mos demtohen nga harku.

Shkarkuesi duhet te jete rezistent ndaj ndotjes se ambjentit ku do te vendoset si avuj uji , pluhura natyror , reres dhe ndotjeve industriale.

Aksesoret e montimit dhe te lidhjes do te jene pjese perberese e shkarkuesit.

Ambienti

I jashtem

Kushtet e perdorimit sipas SSH EN 60099-4

Normal

Parametrat e rrjetit te TM te shperndarjes:

Tensioni nominal

10 000 V

Tensioni me I larte I rrjetit

12000 V

Frekuenca

50Hz

Numrii I fazeve`

3

Tipi I lidhjes se pikes neutrale:

- IT Shumica e rrjeteve te TM
- IT(r) Vetëm rrjetet kabllore ne qytetet e medha

Kohe zgjatja maksimale e difektit

2 ore

Vlera maksimale e mbitesionit te perkohshem (lidhje tokesore)	13.2 kV per 2 ore
Niveli I izolimit	
• Qendrushmeria ndaj tensionit nominal	28 kV
• Qendrushmeria ndaj tensionit imp. te shkarkimeve atmosferike.	75 kV
Rryma e lidhjes se shkurter te shkarkuesit	
• Rryma max. e lidhjes se shkurter tre fazore	20 kA

Kërkesat për shkarkuesin në aspektin e vendit brenda sistemit:

Lidhur me sistemin: ndermjet fazes dhe tokes

Lloji i paisjeve te mbrojtura:

- Linjat ajrore dhe kablllore te TM
- Daljet e kablllove te TM(ne piken e tranzicionit te linjes ajrore ne kablllore)
- - Kabllot e TM(ne pikat e degezimit te linjave ajrore dhe kablllore)
- Trasformatoret TM/TU, TL/TM, reaktoreve(i lidhur direkt ne kabllin e TM)
- Paisjet e tjera te N/stacioneve TM/TU dhe TL/TM(Ne hyrje te tesionit te larte

Te dhena teknike

- Qendrueshmeria ndaj tesionit te impulsit atmosferik 1,2 / 50 mikrosekonda 100kV
- Qendrueshmeria ndaj tesionit(1 min, 50 Hz) ne lageshtire 40kV
- Shkalla e shkarkimeve te pjeseshme ne 1.05 Uc $\leq 10\text{pC}$
- Materiali I rezistences jolineare(varistorit) oksid zingu
- Materiali per izolues i shtreses se jashtme (ne perputhje me SSH EN 60099-4) Polimer
- Materialet e aksesoreve alumini/celik i pa ndryshkshem
- Forca ne terheqje 2 kN
- Forca ne rotullim 50 Nm
- Forca ne perkulje(ne perputhje SSH EN 60099-4) 350 Nm
- Tesioni operativ i vazhdueshem Uc 12 kV
- Qendrueshmeria ndaj tesionit Ur 15kV
- Qendrueshmeria ne shkarkimet nominale $I_n(8/20 \mu\text{s})$ 10 kA
- Rryma me e larte impulsive (4/10 μs) 100 kA
- Klasa e shkarkimit (klasa e energjise) 1
- Forca e lidhjes se shkurter ne 0.2 s 25 kA
- Tesioni maksimal i mbetur ne $I_n=10 \text{ kA}$ –vlera maksimale 42 kV
- Ryma e qendrueshmerise per impuls te gjate 30/60 μs 350 A
- Tesioni me I larte I perkohshem sipas SSH EN 60099-4
 - ✓ Per kohe 100s 16.5 kV
 - ✓ Per kohe 2 ore 15.7 kV
- Gjatesia minimale e ruges se rrymave te rrjedhjes 379 mm
- Gjatesia pa paisje 150 mm
- Pesha 1.5 kg

5. Kërkesa Shtese

Shkarkuesi I TM 10 kV duhet të ketë të mbishkruar:

- Emri ose marka e prodhuesit
- Tensioni nominal, kV
- Rryma nominale e shkarkimit, kA
- Viti i prodhimit
- Markim CE

Keto mbishkrime duhet të jenë të lexueshme qartë dhe të mos fshihen nga kushtet atmosferike

6. Aplikimi

Shkarkuesit e TM 10kV rekomandohen për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike dhe vala e mbitensioneve në zonat me nivel të lartë shkarkimesh

7. Rajoni I aplikimit

Shkarkuesit e TM 10kV përdoren në të gjithë vendin

8. Paketimi

Shkarkuesit e TM 10kV paketohen në kuti kartoni.

Në çdo kuti duhet të shënohet informacioni I më poshtëm

- Emri i prodhuesit
- Numri i kontratës
- Numri i Urdhrit të Blerjes
- Tipi i shkarkuesit
- Numri i shkarkuesave
- Peshë (kg)
- Markim CE

9. Standartet Referuese

SSH EN 60099-4 Shkarkuesit - Pjesa 4: Shkarkuesit me okside metalesh, pa hapësira, për sistemet e rrymës alternative (Surge arresters - Part 4: Metal-oxide surge arresters without gaps for a.c. systems)

SSH EN IEC 60099-5 – Shkarkuesit - Pjesa 5: Rekomandime për përzgjedhjen dhe përdorimin (Surge arresters - Part 5: Selection and application recommendations)

10. Inspektimi dhe Testet

Shkarkuesit e TM 10kV duhet të testohen në përputhje me Standartin SSH EN 60099-4

Tipet e Testeve

Tipet e testeve do të behen në përputhje me standartet SSH, EN, IEC ose standarteve ekuivalente me to. Në qoftë se zotërohen certifikata të testeve të kërkuara, të bera nga një laborator i pavarur në përputhje me keto specifikime, ato mund të pranohen në vend të testeve të kërkuara.

Testet Rutine

Në testet rutine do të përfshihen:



- Testi tensionit referuar frekuences industriale
- Testi I tensionit te mbetur
- Mungesa e shkarkimit te pjesshem dhe zhurma e kontaktit
- Testi qendrueshmerise termike

Testet e Pranimit

Testet e me poshtme standarte te pranimit do te kryhen ne tre shkarkues:

- Testi I tensionit me frekuence nominale
- Testi i qendrueshmerise ndaj tenseve impulsive per kohe te gjate
- Testi I shkarkimit te pjesshem

11. Vizatimet, llogaritjet dhe ceshtjet pershkruese

Ofertuesi duhet te dorezoje informacionin e me poshtem:

- ✓ Vizatimet e pergjitheshme, permasat, peshat
- ✓ Lista referuese e paisjeve identike instaluar ne kushte te ngjashme klimatike dhe sherbimi
- ✓ Katalogun pershkrues, te montimit, perdorimit e tje.

Technical Data Sheet

Shkarkuesa (Surge Arresters)

No.	Tipi (Type)	Unit	Data
1	Te dhena te pergjitheshme (GENERAL DATA)		
	Prodhuesi (Manufacturer) Vendi prodhimit dhe testimit (Place of manufacture and test) Referenca tip (Type reference)		
2	Detaje (DETAILS)		
	Standarti aplikuar (Applied standard) Frekuenca nominale (Rated frequency) Tensioni max i sistemit (Max. system voltage) Tensioni nominal (Rated voltage) Tensioni maksimal operativ i vazhdueshem (Max. cont. Operating voltage) (COV) Kapaciteti minimal i mbitensionit te perkohshem (Min. temporary over-voltage capability) (TOV) - 1 sec - 10 sec. Aftesia e shkarkimit te presionit (Pressure relief capability) Klasa e shkarkimit linear sipas IEC (Line discharge class as per IEC) Rryma nominale shkarkimit sipas IEC (Nominal discharge current as per IEC) Rryma impulsive me e larte qe duron (High current impulse withstand), 4/10 µs Tensioni maksimal i mbetur (Max. residual voltage), 8/20 µs - 2,5 kA - 5 kA - 10 kA - 20 kA Tensioni maksimal i mbetur (Max. residual voltage), 30/60 µs - 500 A - 1000 A Klasa e distances se shkarkimit sipas IEC (Creepage dist. Class as per IEC) Momenti minimal i shkaterimit sipas DIN 48113 (Minimum fracture moment acc to DIN 48113)	Hz kV rms kV kV kV kV kV kArms kA kV crest kV crest kV crest kV crest kV crest kV crest kNm	
3	Numratori shkarkimeve (SURGE COUNTER)		
	Prodhuesi (Manufacturer)		

	Tipi prodhimit (Type designation)		
4	Dimensioned dhe pasha (DIMENSIONS AND WEIGHT)		
	Lartesia (Height)	mm	
	Pasha e nje shkarkuesi komplet (Weight of one complete surge arrester)	kg	
Ofertuesi (Bidder)		Nenshkrimi (Signature)	

Me qene se termat jane teknike, baze do te jete emertimi ne anglisht.


TDSH_MV_SA.xlsx


SAP.xlsx

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SHTYLLA BETON ARME TE CENTRIFUGUARA

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SHTYLLA BETON ARME TE CENTRIFUGUARA

Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



I. TË PËRGJITHSHME

1. Kërkesa të përgjithshme

Shtyllat e betonit të standardizuara ne kete specifikim, do të përdoren në ndërtimin e linjave ajrore te TM dhe TU.

Kontraktori do të optimizojë projektin e linjës duke përzgjedhur kampaten nominale, gjithmone duke marrë në konsideratë kushtet e projektimit të specifikuara më poshtë.

Për trasene e linjes në një vend të hapur për të kapërcyer pengesa të ndryshme, do të përdoren shtylla me lartësi të përshtatshme.

Shtyllat duhet te jene me seksion rrethor me nje vrime te qenderzuar mire pergjate gjithe gjatesise se shtylles dhe me diameter qe ritet ne menyre uniforme nga maja deri ne fund te shtylles.

Cilësia e betonit dhe armimi i tij prej çeliku të përforcuar do të jetë sipas standardeve. Sipërfaqja e jashtme e betonit do të jetë e sheshtë, pa brima ose të çara, siç është përcaktuar në standarte.

Vrima ne maje te shtylles duhet te jete e mbyllur me kapuc betoni per te mos lejuar futjen e ujit.

Kapaciteti(momenti) i shtyllës shprehet me ngarkesën ne perkulje të aplikuar poshtë kokës së shtyllës, siç e përcakton standardi.

Gjatësia e shtyllës duhet të jetë 9 m, 10 m dhe 12 m(Ne raste te vecanta, kryesisht per mirembajtje, per shtylla mbeshtetese mund te perdoren edhe shtylla 8 m; kjo do te percaktohet nga projektuesi).

Te kene marketim CE

2. Detaje teknike

Qellimi

Ky specifikim mbulon projektimin, materialet, prodhimin, inspektimin, testimin, skicimet, transportin dhe dorëzimin e shtyllave të betonit të drejta, të paratensionuara 9, 10 dhe 12 m.

TE DHENA TE PERGJITHESHME		
Tensioni nominal	kV	20 ose 0.4
Frekuenca	Hz	50
Tensioni me i larte I sistemit	kV	24 ose 0.66
Tempertaura maksimale per llogaritjen e shigjetes se varjes	°C	60
Temperature minimale	°C	-20
Trashesia e akullit ne percjelles	mm	10
Shpejtesia maksimale e eres	m/s	35
Mesataraja e rreshjeve vjetore	mm	1000-1500

3. Perfundime

Per qellimin e ketij standarti duhet te aplikohen perfundimet e meposhtme:

Ngarkesa mesatare e perhershme

Ngarkesa e punes qe mund te konsiderohet. me afat te gjate gjate nje periudhe prej nje viti.

Plasartijet periferike

Plasartijet(carjet) qe shkojne pralelisht me seksionin terthor te shtylles se betonit

Moment I plasaritjes

Momenti qe zhvillohet ne shtylle ne kohen e ushtrimit ne te te forces se plasaritjes .

Fortesia e plasaritjes

Pika ne te cilen betoni sapo fillon te ndahet per shkak te tejkalimit te forces se terheqjes ne faqen betonit te shtylles.

Vendosja ne toke

Pjesa e shtylles e cila eshte e projektuar per tu vendosur ne toke ose ne mbeshtetese.

Devijimet e gropes

Specifikime Teknike – Shtylla Betonarme te Centrifuguara 9M, 10M, 12M

Madhesia dhe drejtimi I zhvendosjes se pjeses se shtylles te vendosur ne toke ose ne mbeshtetese ne kushtet e ngarkeses se aplikuar. Zakonisht shprehet ne inc ose mm nga pozicioni vertical me token ose pika ne te cilen pjesa mbeshtetese fillon.

Siperfaqja e terenit(Groundline)

Pika ku fillon ngulja e shtylles. Siperfaqja e terenit perdoret ne projektimin e linjave te transmetimit per percaktimin e distances se percjellesit nga toke. Rezistenca nga pjesa mbeshtetese ne toke fillon ne ose poshte siperfaqes se terenit.

Grupi i vrimave te bulonit

Te gjitha vrimat ne te cilat bashkangjitet gjate montimit nje pjese e vetme e se teres.

Ngarkesa ciklike

Pika ne te cilen nje strukture ka pesuar dipazonin e ngarkesave qe priten te ndodhin mbi jetegjatesine e kesaj strukture.

Ngarkesa e rastit

Grupi I ngarkesave, i kufizuar, (devijimet e gropes) te cilat jane njeheresh te aplikuara ne structure ne nje moment te cakuar..

Koeficienti I ngarkeses

Raporti i ngarkeses perfundimtare terthore me ngarkesen terthore ne plasaritjen e pare

Plasaritjet gjatesore

Plasaritjet ne beton qe shkojne paralelisht ne aksin gjatesor te shtylles.

Perforcimi gjatesor

Celiku perforcues I cili eshte vendosur pergjate aksit gjatesor te shtylles.

Demtmet e shtylles

Pika ne te cilen eshte aplikuar forca maksimale. Demtimi zakonisht ndodh me thermim te betonit ose deformime permanente.

Beton I paratensionuar

Betoni I armuar ne te cilin tensioni I brendeshem eshte aplikuar per te reduktuar tensionin ne terheqje potencial qe rezulton nga ngarkesat.

Shtylle betoni centrifugale

Nje shtylle e cila eshte prodhuar duke vendosur fije celiku te paratensionuar dhe perforcuar me spirale ne nje kallep, duke shtuar beton te sapo pergatitur dhe duke rrotulluar kalleepin per te formuar shtyllen.

Transverse

Drejtimi i linjes ndan kendin qe perfshihet nga percjellesit ne shtylle. Ne rastin e nje linje te drejte, kjo do te jete pingul me drejtimin e linjes.

Specifikime Teknike – Shtylla Betonarme te Centrifuguara 9M, 10M, 12M

Ngarkesa terthore ne plasaritjen e pare

Per ndertim, ngarkesa terthore ne plasaritjen e pare nuk duhet te merret me pak se ngarkesa e punes.

Ngarkesa e punes

Ngarkesa maksimale ne drejtimin terthor, qe ndodh vazhdimisht duke perfshire forcen e eres ne shtylle. Ngarkesa supozohet te veproje ne nje pike 600 mm poshte majes se shtylles se future ne toke.

Demtmet perfundimtare

Kushtet ekzistuese kur shtylla nuk eshte me e ngritur si rezultat I shtimit te ngarkeses , ose demtimi I betonit ose thyerje gjate paratensionimit ose terheqje permanente te celikut ne ndonje pjese te shtylles.

Ngarkesa terthore perfundimtare

Ngarkesa ne te cilen demtimi ndodh kur ajo aplikohet 600 mm poshte dhe pingul me aksin e shtylles pergjate drejtimin terthor me pjesen e poshtme te shtylles sic tregohet ne ndertim.

Ngarkesa perfundimtare

Ngarkesa maksimale e projektimit qe perfshin koeficientin e ngarkeses te specifikuar.

Kapaciteti I momenti perfundimtar

Momenti qe zhvillohet ne shtylle ne kohen kur fortesia perfundimtare ne structure eshte realizuar.

Forca perfundimtare

Forca maksimale ne diagramin e force-tendosje. Per shtyllen, kjo konsiderohet te jete pika ku shtylla demtohet zakonisht me thermim te betonit.

Forca e epjes

Forca minimum ne te cilen cdo material do te filloje te deformohet fizikisht pa rritje te metejshme ne ngarkese ose forcave te perhershme. Ky njihet si kufiri limit I elasticitetit te materialit.

4. Standartet

Projektimi, prodhimi dhe testimi i shtyllave duhet te jete ne perputhje me standartet e me poshtme:

- SSH EN 12843 Produkte të parafabrikuara të betonit - Shtyllat dhe traret(Concrete prefabricates- masts and poles)
- SSH EN 10080 Concrete reinforcement steel- Reinforcement steel suitable for welding- General terms(Çelik për përforcimin e betonit - Çelik i përforcuar i saldueshëm - Të përgjithshme)
- SSH EN 12620 Agregatet e betonit(Concrete aggregate)
- SSH EN 1097- 1 Provat për vetitë fizike dhe mekanike të agregateve - Pjesa 1: Përcaktimi i rezistencës ndaj fërkimit (mikro-Deval)(Tests for mechanical and physical properties of aggregates - Part 1: Determination of the resistance to wear (micro-Deval))

- SSH EN 1097-2 Provat për vetitë mekanike dhe fizike të agregateve - Pjesa 2: Metoda të përcaktimit të rezistencës ndaj copëzimit (Tests for mechanical and physical properties of aggregates - Part 2: Methods for the determination of resistance to fragmentation)
- SSH EN 1367- 1 Prova për vetitë termike dhe klimaterike të agregateve - Pjesa 1: Përcaktimi i rezistencës në ngrirje dhe shkrije (Tests for thermal and weathering properties of aggregates - Part 1: Determination of resistance to freezing and thawing)
- SSH EN 196- 1 Metoda prove për çimento - Pjesa 1: Përcaktimi i fortësisë (Methods of testing cement - Part 1: Determination of strength)
- SSH EN 196- 7 Metoda prove për çimento - Pjesa 7: Metoda për marrjen dhe përgatitjen e mostrave të çimentos (Methods of testing cement - Part 7: Methods of taking and preparing samples of cement)
- SSH EN 197-1 Çimento - Pjesa 1: Përbërja, karakteristikat dhe kriteret e konformitetit për çimentot e zakonshme (Cement - Part 1: Composition, specifications and conformity criteria for common cements)
- SSH EN 197-2 Çimento - Pjesa 2: Vlerësimi i konformitetit (Cement - Part 2: Conformity evaluation)
- SSH ISO 1920- 1 Testimi i betonit - Pjesa 1: Marrja e mostrës së betonit të sapo përgatitur (Testing of concrete - Part 1: Sampling of fresh concrete)
- SSH ISO 1920-3 Testimi i betonit - Pjesa 3: Marrja dhe trajtimi i mostrës (Testing of concrete - Part 3: Making and curing test specimens)
- SSH ISO 1920-4 Testimi i betonit - Pjesa 4: Rezistenca e betonit të ngurtësuar (Testing of concrete - Part 4: Strength of hardened concrete)

Per aspektet e pergjitheshme, materialet perberese te betonit, celikut te paratesionuar, perfshire dhe lidhesit, do te zbatohet standarti SSH EN 13369:2023, klauzola 4.1.

Prodhimi i betonit duhet të jenë në përputhje me SSH EN 13369: 2023, pika 4.2.

5. Procedura e testimit

Testet per betonin duhet te behen ne perputhje me SSH EN 13369:2023 klauzola 5.1.

Matja e dimensioneve

Dimensionet do te maten me paisje qe kane nje sakesi $\pm 1\text{mm}$ me perjashtim te gjatesise se shtylles qe do te matet me sakesi $\pm 0,5\%$. Pajisjet matëse dhe metodat e testimit do të përshkruhen në dokumentet e kualitetit të prodhuesit.

Veshja me beton

Testimi i betonit veshes perforcues, mund të jenë shkatërruese ose jo-shkatërruese, do të kryhet me një saktësi prej $\pm 2,0\text{ mm}$. Metoda e përdorur për këtë testim do të përshkruhen në kontrollin e prodhimit fabrikë.

Rezistenca mekanike

Testi eshte i perbere nga:

- Matja e deformimit gjate aplikimit te momentit te perkuljes
- Ngarkesa deri ne shfaqjen e plasaritjen e betonit (load when the first transversal crack appears in case of pre-stressed concrete)
- ngaekesa perfundimtare (ultimate load)
- Ngarkesa perfundimtare ne perdredhje (ultimate torsional load)

Testi ne perkulje

Testi do te kryhet ne nje shtylle horizontale, mbeshtetur fort, te shtrire ne nje nje support te levizshem per te shmangur efektet per shkak te peshes dhe te lejoje levizjen e lire te saj.

Nëse nuk definohet as në deklaratën e prodhuesit apo në kërkesat e blerësit, ngarkesa do të zbatohet në $90^\circ (\pm 5^\circ)$ te aksit qendror te shtylles, jo te deformuar. Shpejtesia e ngarkimit, aplikuar nen kontrollin e forcave duhet te jete i kufizuar ne 100N/s pa ndonje shok apo impakt. Një saktësi prej $\pm 3\%$ është e nevojshme për ngarkesat e aplikuara të testit dhe në deformimet e matura.

Testi elasticitetit

Testi I kapacitetit mbajtes

Testi perdredhjes

Testi do të kryhet në një shtyllë në pozicion horizontal. Maja e shtylles do te jete e lire dhe deformimi duhet te shmanget. Testi gjatesise embedment eshte percaktuar ne kerkesat e bleresit ose ne deklaraten e prodhuesit. Ajo përcakton seksion kryq embedment. Rritja e momentit rrotullues do te kufizohet ne 100Nm/s pa ndonje shok apo impakt. Një saktësi prej $\pm 3\%$ do të kërkohet mbi ngarkesat e aplikuara të testit.

5. Vleresimi I konformitetit dhe pajtushmerise se kriterëve

Pajtueshmëria e produktit me kërkesat e standardit duhet të demonstrohet nga:

- Tipi fillestar i testimit
- Kontrolli i prodhimit në fabrikë

Klauzola 6.1 e SSH EN 13369: 2023 duhet të zbatohet

Tipi i testit


Duhet te zbatohet klauzola 6.2 e SSH EN 13369:2023. Dispozitat specifike plotësuese mund të përcaktojnë kriteret e pajtueshmërisë. Tipet e testeve te me parshme te realizuara perpara aplikimit te standartit te tanishem mund te perdoren si teste tip me kusht qe ata jane per te njejten familje produkti me te njejten metode dhe kerkesa te testit.

Kontrolli I produktit ne fabrike

Duhet te zbatohet SSH EN 13369:2023, 6.3

Ispektimi i skemes per shtyllat do te kryhen ne pajtim me SSH EN 13369: 2023, Anekset 0.1-0.3 dhe 0.5. testi ne shtypje do te kryhet sipas SSH EN 13369: 2023, Anekset 0.1-0.3 dhe 0.5.

6. Ilustrimi



II. KERKESA TEKNIKE TE DETAJUARA

1. Kerkesa teknike te detajuara (pjeresia e shtylles 1.5%)

Shtylla 8.0 m (vetem mbeshtetese ne rastin e riparimeve)

Dimensionet e diametrave jane te rekomanduar

Kriteret e ndertimit	Njesia	Gjatesia/Forca (m/kN) Shtylla 8/6
Gjatesia	m	8
Diametri d1	mm	130
Diametri d2	mm	250
Vlera e forces nominale operuse	kN	6

Shtyllat 9.0 m

Dimensionet e diametrave jane te rekomanduar

Kriteret e ndertimit	Njesia	Gjatesia/Forca (m/kN)		
		Shtylla 9/6	Shtylla 9/10	Shtylla 9/15
Gjatesia	m	9	9	9
Diametri d1	mm	150	180	220
Diametri d2	mm	285	315	355
Vlera e forces nominale operuse	kN	6	10	15

Shtyllat 10.0 m

Dimensionet e diametrave jane te rekomanduar

Kriteret e ndertimit	Njesia	Gjatesia/Forca (m/kN)		
		Shtylla 10/6	Shtylla 10/10	Shtylla 10/15
Gjatesia	m	10	10	10
Diametri d1	mm	150	180	220

Specifikime Teknike – Shtylla Betonarme te Centrifuguara 9M, 10M, 12M

Diametri d2	mm	300	330	370
Vlera e forces nominale operuse	kN	6	10	15

Shtyllat 12.0 m

Dimensionet e diametrave jane te rekomanduar

Kriteret e ndertimit	Njesia	Gjatesia/Forca (m/kN)		
		Shtylla 12/6	Shtylla 12/10	Shtylla 12/15
Gjatesia	m	12	12	12
Diametri d1	mm	180	220	250
Diametri d2	mm	360	400	430
Vlera e forces nominale operuse	kN	6	10	15

Parametrat teknik

Lloji i shtylles [m/kN]	Ngarkesa e lejuar [kN]	Gjatesia e shtylles [m]	Thellesia e futjes ne toke [m]	Diametri ne maje "d1" [mm]	Diametri ne baze "d2" [mm]
8/6	6	8	1.25	130	250
9/6	6	9	1.6	150	285
9/10	10	9	1.8	180	315
9/15	15	9	1.8	220	355
10/6	6	10	1.8	150	300
10/10	10	10	2.0	180	330
10/15	15	10	2.0	220	370
12/6	6	12	2.2	180	360
12/10	10	12	2.5	220	400
12/15	15	12	2.5	250	430

2. Zgjedhja e shtyllave

Ky kapitull përcakton llojet e rekomanduara të shtyllave si dhe funksionin e duhur të shtyllës përgjatë shtrirjes se linjes, ne varesi te seksionin te percjellesit dhe kushteve specifike te ngarkeses se punes.

Shtylla ndermjetese (mbajtese)

Një shtyllë ndermjetese përdoret kur përcjellësit/telat janë varur ne shtyllë dhe tensioni mekanik është i njëjtë nga të dy anët.

Specifikime Teknike – Shtylla Betonarme te Centrifuguara 9M, 10M, 12M

Në këtë rast, supozohet që shtylla të perballoje një forcë në rënie (perpendikular poshte) dhe një forcë anësore, por jo një forcë gjatësore.

Këto shtylla përdoren aty ku linja ajrore vazhdon në mënyrë lineare ose kthehet në një kënd të ngushtë. Në raste të tjera, do të përdoret shtylla ankerore.

Aplikimi :

- Linja lineare ose këndore me kënd $\leq 20^\circ$
Lloji i shtyllës 9/6, 10/6 or 12/6

Shtyllat Tensionuse/Ankerore/ Fundore/Shtyllat pa vazhdim (Ankerore Fundore) (Dead-end poles)

Shtyllat në fund të një seksioni linear të linjës, aty ku linja mbaron ose merr kënd në një drejtim tjetër quhen shtylla tensionuse/Ankerore/Fundore/Ankerore Fundore. Këto shtylla duhet të perballojnë forcat gjatësore të seksioneve dhe gjatësive me te medha te percjellesave. Zakonisht, ato kane një konstruksion ndertimi me te rende.

Aplikimi:

- këndi ($>20^\circ$) - ($\leq 60^\circ$)
Lloji i shtyllës 9/10, 10/10 or 12/10
- këndi ($>60^\circ$) - ($\leq 90^\circ$) ose shtylla ankerore , fundore, ankerore fundore
Lloji i shtyllës 9/15, 10/15 or 12/15

3. Ndertimi

Shtyllat duhet të jenë në gjendje t'i rezistojnë të gjitha rasteve të specifikuara të ngarkesës, duke përfshirë erën mbi shtylla dhe tërheqjen dytësore nga devijimi, shmangia dhe lëvizja e bazamentit. Shtylla do t'i rezistojnë ngarkesave pa pasur demtime si dhe duke mos tejkaluar limitet e devijimeve te specifikuara.

Shtyllat do t'i rezistojnë kushteve të ngarkesës, duke përfshirë edhe faktorë specifik të ngarkesës. Projektimi i shtyllës do të përfshijë toleranca për faktorët e ngarkesës nga trajtimi, transporti dhe ngritja pa demtime e saj, si dhe deformimin e përhershëm apo dëmtimin e shtyllës.

Shtyllat do të projektohen në mënyrë të tillë që qendrueshmëria ne thyerje e shtyllës e tejkalon forcën e kerkuar, e cila llogaritet nga ngarkesat e sherbimit të aplikuara në shtyllë.

4. Materialet

Te gjitha ankoruset e siguruara nga fabrika duhet te jene te galvanizuara ne te nxehte ose material jo korroziv. Pllakat kadmium dhe material alumini nuk duhen perdorur. Te gjitha materiet duhet te jene jo korrozive prodhuar enkas per kete qellim bazuar ne rekomandimet e fabrikes. Nese prodhuesi I konsideron heqjen e paisjeve levizese te nevojshme apo te pershtatshme, ato mund te jene te derdhura ne shtylle me paisje levizese.

Specifikime Teknike – Shtylla Betonarme te Centrifuguara 9M, 10M, 12M

Betoni duhet te kete minimum pas 28 ditesh nje fortesi ne shtypje prej 5,000 psi me nje vlere maksimum te permbajtjes se uje-cimento 0.40. Fortesia me e madhe dhe vlere me e vogel uje-cimento kompensojne kerkesat per celikun.

Agregati I holle duhet te jete rere natyrale, me grimca te pastra te forta, te ashpra dhe me te gjitha specifikimet e perfshira me poshte. Agregati duhet te jete i nje klase te mire.

Agregati I ashper duhet te jete I paster, me gure te thyer dhe I nje cilesie te mire. Agregati duhet te jete I lagur me uje para se te perdoret ne beton.

Agregati duhet te testohet per tu percaktuar ndonje reaksion alkaline-agregat. Guret e copetuar ose guret e copetuar pjeserisht jane burimi I agregatit.

Uji duhet te jete I paster pa permbajtje vajrash, acidesh, alkalinesh, kriprash ose material organike apo material te tjera te demshme.

Perzierja nuk duhet te permbaje jone kloruri ne sasi qe mund te shkaktojne ne permbajtjen totale te klorurit ne beton qe te tejkaloje 0.4 pound per meter kub

Vetite mekanike te celikut te paratensionuar, , celik I perforcuar dhe perforcimet spirale duhet te jene ne perputhje me standartet e perdorura.

Kerkesat per perzierjen dhe ndertimin e betonit sipas listes se mesiperme mund te ndryshohet me aprovimin e bleresit.

5. Forma gjeometrike(Workmanship)

Shtylla duhet te jete me seksion rrethor dhe diametri i matur ne cfardo vendi ne shtylle, nuk duhet te varioje me shume se 0.6 cm nga ndonje matje tjeter bere ne ate seksion terthor.

Shtylla duhet te kete forme uniforme konike nga fillimi deri ne fund.

Pjeresia duhet te jete jo me pak se 1.5%, bazuar ne standartin SSH EN 12853 - Concrete prefabricates - masts and poles. Diametri ne maje te shtylles eshte fiks si ne tabelat e paraqitura ne kete material.

Devijimi I shtylles eshte I lejuar ne nje plan dhe ne nje drejtim. Nje vije e drejte qe lidh skajin e shtylles ne fund dhe skajin e shtylles ne fillim nuk duhet te jete larg nga siperfaqja e shtylles me teper se 0.6 cm per cdo 3 m gjatesi midis ekstremeve. Tensionimi do te te kryhet ne menyre qe te mbaje forcat e tensionimit simetrike.

Kufinjte e paratensionimit te celikut nuk duhet te tejkalojne:

- 80 perqind e forces perfundimtare ose 94 perqind te forces se epjesme ose vleren maksimale te celikut te paratensionuar te rekomanduar nga prodhuesit ose teforces se terheqjes (jacking force)
- 74 perqind te forces perfundimtare, ose 82 perqind te forces se epjesme menjehere pas paratensionimit dhe
- 70 perqind te forces perfundimtare per celikun pas tensionimit ne ankorim dhe mberthim menjehere pas ankorimit.

Specifikime Teknike – Shtylla Betonarme te Centrifuguara 9M, 10M, 12M

Distanca e lire midis fijeve te celikut te paratensionuar duhet te jete $\frac{4}{3}$ here e madhesise maksimale te gregatit ose sa tre here diametri i fijes, i cili eshte me i madhi. Ne rastin kur ky kusht nuk permbushet ne nje pike te shtylles, hapësira me te vogla do lejohen me kusht qe vendosja e betonit do te realizohet e kenaqeshme, transferimi adekuat i stresit mund te ndodhe dhe kushte te caktuara jane perdorur per ruajtjen e apesirave midis fijeve te celikut te paranderur.

Prodhuesi duhet te siguroje (sipas kerkeses se bleresit) vrime tejpertej cdo shtylle. Vrimat do te performohen duke futur shufra PVC(ose material te tjera te pershtateshme) te cilat qendrojne ne shtylle. Perdorimi behet me urdher te bleresit. Shufrat performuese do te jene me madhesi te tille qe te realizojne nje vrime me diametrin e kerkuar dhe do te jene me gjatesi sa diametri I jashtem I shtylles ne ate pike ku vendosen duke qene rafsh me siperfaqen e jashtme te shtylles. Pervec rasteve kur shenohet ndryshe ne vizatime, vrime do te jete pingul me aksin e shtylles.

Prodhuesi duhet te siguroje ne shtylle futjet performuese ne dy lokacione per te lejuar qarkullimin e ajrit brenda shtylles. Diametri minimal I tyre duhet te jete 3 cm. Lokacionet duhet te jene jo me larg se 3 metra nga maja dhe jo me shume se 3 metra nga siperfaqja e terenit(vija e tokes).

Vrimat nuk duhet te shpohen ne paretin(trashesine) e shtylles pervec si menyre specifike e nevojshme per te korigjuar gabimet ose leshimet dhe vetem me miratim te bleresit.

Vrimat nuk hapen gjate murit te shtylles, vetem ne rastet kur kerkohet per te rregulluar pjeset qe jane lene jashte dhe vetem nese eshte aprovuar nga bleresi

Fijet gjatesore te celikut nuk duhet te jene te prera , pervec ndonje rasti te vecante te aprovuar nga bleresi. Bleresi mund te refuzoje cdo shtylle ne te cilen celiku eshte i prere.Te gjitha pjeset e celikut qe jane te ekspozuara nga vrimat e bera duhet te mbulohet me psate epoxy. Siperfaqet e krisura duhet te pastrohen dhe te mbushen me paste epoxy ose beton te derdhur.

Bleresi ka te drejte te refuzoje cdo shtylle ne te cilen kryerja e nje lidhje me bullona mund te reduktohet per shkak te mungeses ose performimi te qarte te nje vrime te shpuar.

6. Tokezimi

Do të përdoret nje percjelles tokezimi i brendshem . Per lidhjen e percjellesit te tokezimit te shtylles me tokezimin e jashtem do te perdoren elemente te filetuar nga brenda(dado), pozicioni i te cileve ne shtylle tregohet ne vizatimet perkatese dhe sqarohet me poshte.

Fija e celikut e perfshire ne lidhje do te jete tokezimi i brendshem i shtylles. Minimumi nje percjelles celiku gjatesor (me diameter jo me te vogel se 12 mm) do te lidhet elektrikisht me elementet prej bronzi(dado bronzi M12) te filetuar nga brenda, te cilet jane vendosur ne maje dhe ne fund te shtylles.

Dadoja e siperme do te vendoset ne nje distance 60 cm poshte majes se shtylles, kurse e poshtmeja do te vendoset ne nje distance 30 cm mbi siperfaqjen e tokes(Groundline)

7. **Perfundime**

Sipërfaqja e shtyllës duhet te jete pa të çara apo krisje. Të çarat do të ngjiten ose me ane të përdorimit të sistemit të injeksionit të materialit epoxy duke iu referuar specifikimeve të prodhuesit te materialit epoxy, ose me anë të hapjes se kanaleve ne forme V pergjate carjes në një pjerrësi 1:1 me një thellësi minimale prej 0.6 cm, dhe më pas duke e mbushur kanalin V me material epoxy. Mbulimi i të çarave me një mbulesë epoxy nuk do të lejohet.

Zgavrat e vogla të shkaktuara nga flluskat e ajrit, vendet e gërryera nga krimbat apo boshllëqe të tjera të vogla do të meremetohen në mënyrë të hollësishme, do të pastrohen me ujë dhe më pas do të mbushen me kujdes me llaç cimentoje. Një zgavër e vogël përcaktohet si e tillë nqse diametri i saj eshte jo më i madh se 1.5 cm dhe thellesia jo më e thellë se 0.6 cm.

Nëse ndonjë zgavër apo boshllëk thith uje, gjë që tregon se boshllëku shtrihet në trupin e shtyllës, atëherë kjo shtyllë nuk do të pranohet apo përdoret.

Prodhuesi duhet të vulosë të dy anët e shtyllës si dhe duhet të mbrojë pjeset e çelikta nga korrozioni. Sistemi i përdorur do të miratohet nga blerësi.

8. **Emertimi**

Çdo shtyllë do të identifikohet nga etiketa e identifikimit të prodhuesit, etiketa e identifikimit të shtyllës dhe etiketa e sigurimit teknik. Informacioni i mëposhtëm do të stampohet në etiketë me germa jo më të vogla sesa 1 cm në lartësi dhe me ngjyrë të zezë.

- Etiketa e identifikimit të prodhuesit:

Emri i prodhuesit
Data, muaji dhe viti i prodhimit
Numri i strukturës
Gjatësia e shtyllës
Kapaciteti(momenti) ne siperfaqen e tokes, ose pika e fiksimit
Logo e blerësit / OSHEE
Ngjyra e sfondit – gri
Ngjyra e kornizës – e gjelbër me trashësi 10 mm
Dimensionet, ngjyra e sfondit dhe kornizës – e negociueshme

- Etiketa e identifikimit të shtyllës (linja TU):

Emri i pikës së transformimit
